

RAPORT
I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Për Programin e studimit MP në “Financë” me profile:

- Banka
- Sigurime
- Kontabilitet dhe raportim financiar
- Qeverisje dhe auditim
- Politika fiskale

Ofruar nga Universiteti European i Tiranës

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof.Dr.Halit XHAFA

Prof.Dr.Drini SALKO



Maj / 2018

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit MP në Financë me profile:

- Banka
- Sigurime
- Kontabilitet dhe raportim financiar
- Qeverisje dhe auditim
- Politika fiskale

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Universiteti Europian i Tiranës
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti Ekonomik dhe i Teknologjisë së Informacionit
3	Urdhëri/VKM i licencimit	VKM Nr. 74, datë 21.01.2009
	Urdhëri i riorganizimit	Urdhër Nr. 233, datë 06.06.2013
4	Urdhëri i Akreditimit të parë	Urdhër Nr.68 date 14.02.2011
5	Titulli i programit të studimit:	MP në Financë me profile : <ul style="list-style-type: none">• Banka• Sigurime• Kontabilitet dhe raportim financiar• Qeverisje dhe auditim• Politika fiskale
6	Cikli i studimit:	Cikli i dytë i studimit
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit akademik *
8	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	-
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	7
16	Aktivizimi i programit të studimit	2011-2012
17	Numri i studenteve per program studimi	140 **

*Nga viti 2012-2013 deri në vitin 2016-2017 , kohëzgjatja e programit të studimit ka qenë 1 dhe 1.5 vite akademike, në përputhje me Urdhërin Nr.233, datë 06.06.2013, aktualisht ky program ofrohet vetëm në 1vit akademik.

** Të dhënat për numrin e studentëve i përkasin vitit akademik 2017 - 2018

Shenim: Tabela plotësohet nga Specialisti i ASCAL



HYRJE

Universiteti Europian i Tiranës si institucion i Arsimit të Lartë është krijuar fillimisht si Shkollë e Lartë Universitare Jo Publike me VKM nr. 636 datë 20.09.2006 të Këshillit të Ministrave, “Për dhënien e lejes për hapjen e Shkollës së Lartë Universitare Jo Publike. Me VKM nr. 657, datë 28.09.2011 emërtimi i institucionit është ndryshuar nga Shkolla e Lartë Universitare Jopublike “Universiteti Europian i Tiranës”, në “Universiteti Europian i Tiranës”. UET i është nënshtruar procesit të vlerësimit të jashtëm institucional, në zbatim të kontratës së nënshkruar midis MAS dhe QAA dhe Manualit të posaçëm QAA – APAAL, proces i finalizuar me Vendimin e Bordit të Akreditimit (VBA), Nr. 12, datë 07.04.2017 “Për akreditimin periodik të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Europian i Tiranës”. Me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 68, datë 14.02.2011, është akredituar për herë të parë edhe programi Master i Nivelit të Parë në “Banka dhe Sigurime” me 3 profile dhe i riorganizuar me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr 233 date 06.06.2013 si Master Profesional (MP) në Finance me 5 profile; *Banka; Sigurime; Kontabilitet dhe raportim financiar; Qeverisje dhe auditim dhe Politika fiskale* në variantet me 60 ECTS dhe 90 ECTS.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) për realizimin e procesit të vlerësimit u mbështet në një seri dokumentash dhe kërkesash të ndryshme në lidhje me standardet dhe mënyrën e funksionimit të gjithë strukturave të Universitetit Europian të Tiranës. Burim i rëndësishëm për vlerësimin e jashtëm shërbeu Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i cili ishte rezultat i bashkëpunimit ndërmjet stafit akademik dhe atij administrativ të UET. Një rol të rëndësishëm në këtë vlerësim kanë dhe vizitat në vend që u realizuan pranë UET-te, takimet me drejtues të këtij institucioni si shqyrtimi i dokumentacionit bazë mbi të cilën organizohet i gjithë programi i studimit. Gjatë vizitës në vend u realizuan takime me drejtues të Institucionit, me drejtues të departamentëve, grupin e vlerësimit të brendshëm, stafin pedagogjik, studentë, sekretarinë mësimore, administratën, arkivin, etj. Gjithashtu u bë vizitë në mjediset mësimdhënëse të këtij Institucioni, në bibliotekën e shkollës, në sallën e kompjuterëve etj. Në verifikimin e të dhënave u përdor metoda e marrjes së mostrës, duke nxjerrë në mënyrë të rastësishme kampionët për verifikim. Kjo metodë u përdor në verifikimin e të dhënave lidhur me cilësinë e studentëve, procedurave të regjistrimit të studentëve në sekretari, me të dhënat për hyrje dhe dalje të studentëve në vite dhe lidhur me frekuentimin e leksioneve dhe të seminareve. Gjithashtu gjykimi i grupit të punës u mbështet në intervistat e marra nga grupet e ndryshme të interesit (drejtues, grupi i vlerësimit, stafi pedagogjik, studentë, punonjës të administratës, etj).

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)


Përbërja e GVJ:

Prof.Dr.Halit XHAFA

Prof.Dr.Drini SALKO

Menaxhere vlerësimi e kësaj procedure është specialistja e ASCAL Znj. Majlinda Demirneli.

Më datë 27.04.2018 përmes sistemit dhe me shkresë zyrtare me Nr. 25/26 Prot me lëndë:” Dërgohet Draft Raporti i Vlerësimit të Jashtëm”, UET është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. UET përcjell në ASCAL nëpërmjet shkresës nr. 10/20 prot, datë 07.05.2018 komentet në lidhje me Draft – Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pasi lexoi me kujdes përgjigjen e UET, paraqiti argumentimin për secilin nga komentet dhe vendosi: të marrë në konsideratë dhe të reflektojë ndryshimet në RVJ për komentin 1 (fq. 1 të objeksioneve); të marrë në konsideratë dhe të reflektojë ndryshimet në RVJ dhe për komentin 5 (fq. 5 të objeksioneve). Pas reflektimit të komenteve nga 11 rubrika të vleresuara në 7 prej tyre standardet plotësohen plotësisht dhe në 4 te tjerat standardet plotësohen kryesisht.



ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKKREDITIMIN E PARË


I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit

Nga Raporti i Vlerësimit të Jashtëm i vitit 2010 dhe Vendimi i Këshillit të Akreditimit për këtë program studimi janë bërë këto rekomandime:

- a. Të bëj ndryshimet e nevojshme në planin mësimor për të strukturuar më mirë disiplinën e formimit të përgjithshëm dhe ato të detyrueshme specifike për çdo profil.
- b. Të harmonizohet më mirë shpërndarja e mësimdhënies në kohë gjatë javës
- c. Të vazhdohet puna e nisur me bashkëpunimet brenda dhe jashtë duke institucionalizuar ato me marrëveshje të qëndrueshme edhe në trojet shqiptare.
- d. Të aplikohen procedura të vecanta në pranim
- e. Të hartohen programe të plota të kërkimit shkencor.
- f. Të pasurohet fondi i bibliotekës dhe hapësirat e saj.

I. Plotësimi i tyre nga Institucioni

- a. Situata me syllabluset paraqitet e përmirësuar në krahasim me akreditimin e parë si në drejtim të strukturimit, përmbajtjes, rjedhës logjike të temave, literaturës së përfshirë etj. Janë bërë ndryshimet maksimale të mundshme në kurrikulën e programit (janë zëvendësuar 2 lëndë). Megjithatë, ka lëndë të njëjta që zhvillohen me të njëjtin syllabus si në programin Msc në Financë Bankë ashtu edhe në këtë program, kur synohet që vetë MP në Financë, syllabusi të ketë më shumë orientim aplikativ. Mbetet të rishikohen në vazhdimësi përsëritje të temave në disa lëndë dhe eliminimi i tyre sa më i mundshëm me qëllim rritjen e cilësinë, etj. **Ky rekomandim është plotësuar kryesisht**
- b. Kjo mangësi është eliminuar gradualisht gjatë viteve pas akreditimit të parë duke rritur numrin e pedagogëve të brëndshëm me tituj e grada (Shih Tabela 2 tek aneksi). Për vetë faktin e zhvillimit të një numri të kufizuar lëndësh në këtë program (6 lëndë për programin e çdo profili) por edhe të rritjes së PAE në Departamentin e Financës dhe Ekonomiksit pothuajse mbi 77 % e mësimit në vitin akademik aktual zhvillohet nga personel efektiv. **Ky rekomandim është plotësuar plotësisht.**
- c. UET gjatë 3 viteve të fundit ka rritur nivelin e bashkëpunimit në nivel lokal dhe nderkombëtar, gjë që kontribon në marrjen e praktikave më bashkëkohore akademike në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies lidhur me personelin akademik dhe studentët. Bazuar në të dhënat e marra gjatë vizitës në institucion dhe RVB, institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi në nivel lokal partneritet, shkëmbime akademie apo Erasmus + , me 15 institucione të arsimit të lartë në Shqipëri dhe me 16 institucione të tjera të shoqërisë publike. Zhvillim pozitiv në këtë fushë shohim në marrëveshjet e bashkëpunimit ndërkombëtar të institucionit. Kështu gjatë kësaj periudhe ka pasur apo është në proces bashkëpunimi me rreth 93 universitete apo institucione Europiane në kuadër të projekteve të ndryshme ERASMUS + , partnership etj. Nga ky numër 6 marrëveshje bashkëpunimi janë me Universitetet në Kosovë. Ky numer i madh marrëveshjesh bashkëpunimi që ka përfshirë të tre nivelet e programeve mësimore që zhvillohen ka mundësuar edhe realizimin e mobiliteteve në kuadër të shkëmbimeve të stafit, personelit



administrativ dhe studentëve të UET-së, me këto institucione partnere. **Ky rekomandim është plotësuar plotësisht.**

- d. Lidhur me procedurat e veçanta të pranimit në institucion për studentët, nga verifikimi në institucion i procesit të regjistrimit të studentëve rezulton se tashmë kemi procedura te plota regjistrimi bazuar në rregulloret e miratuara në institucion gjë që e pamë në dosjet e studentëve të regjistruar. **Ky rekomandim është plotësuar plotësisht.**
- e. Tashmë UET e bazon veprimtarinë e vet edhe në startegjinë e zhvillimit shkencor afatmesëm që është miratuar, Në bazë të kësaj strategjie Fakultetet dhe njesitë bazë mësimore shkencore (ku bën pjesë edhe Departamenti i Financës dhe Ekonomiksit si njësi që mbulon këtë program) kanë planet e tyre afatmesme shkencore dhe realizojnë një vlerësim bashkohor të performancës shkencore të stafit akademik. **Ky rekomandim është plotësuar plotësisht**
- f. Rekomandim dhe mangësi në analizën swot ishte mungesa e titujve në gjuhën shqipe. UET është angazhuar vitet e fundit në një program përkthimesh të disa teksteve bashkëkohorë të autorëve më të njohur në botë në fushën e financë bankës gjë që e ka përmirësuar këtë situatë. Meqënëse përdorimi i tyre vështirësohet herë pas here për shkak të diferencave në ambientin ekonomik, sipas edhe vizitës në bibliotekë, thuaj se mungojnë botime të autorëve vendas në disiplina bazë apo edhe në ato me zgjedhje. Pra ka ende gjera për t'u ndjekur dhe plotësuar në këtë drejtim. **Ky rekomandim është plotësuar kryesisht.**

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Hartimi i programit të studimit Master Profesional (MP) në Financë është bazuar në misionin që ka vetë UET i cili kërkon të arrijë një nivel cilësie të lartë në formimin akademik të studentëve dhe përgatitjen e specialistëve dhe kërkuesve të rinj në fushën e financës me dije të qëndrueshme teoriko praktike. Në funksion të këtij misioni, programi MP në Financë me profile, synon të pajisë studentët me koncepte bazë të teorisë por para së gjithash me ato të aplikuara në financë duke i gërshetuar njohuritë e marra në aspektin teorik me aftësitë praktike dhe aplikative. Si rrjedhojë objektivi kryesor i programit MP në Finance me profile është që të arrijë të formojë ekspertë apo specialist me aftësi teoriko praktike e aplikative në fushën e financës me profil *bankat, sigurimet, kontabilitet dhe raportim financiar, qeverisje dhe auditim dhe politike fiskale*. Në funksion të këtij objektivi kryesor është ndërtuar edhe kurrikula përkatëse e cila nëpërmjet moduleve të cilat trajtojnë aspektet teoriko praktike rreth bankave, kompanive të sigurimeve, kontabilitetit dhe analizës financiare, auditimit dhe fiskalitetit.

Në përputhje me ndryshimet e fundit në ligjin për arsimin e lartë, duke filluar nga viti akademik 2016-2017 programi ofrohet vetëm me kohëzgjatje normale një vit akademik, me gjithsej 60 ECTS. Ky program bazohet edhe në strategjinë e zhvillimit shkencor të UET-se duke u bazuar në literature mësimore bazë nga


autorë të njohur ndërkombëtarisht në vendet e Europës dhe në SHBA si dhe në programe të bazuara në eksperiencën e universiteteve të mirënjohura në botë. Programi MP në Financë me profilet e përmendura më sipër mbështetet në një kurrikulë e cila përgjithësisht merr parasysh edhe zhvillimet ekonomiko, sociale të viteve të fundit si dhe kërkesat në rritje të tregut të punës për specialist të aftë në fushën e financës por edhe në profile të veçanta të kësaj fushe.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve ¹
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>	<p>Programi i studimit MP në Financë me profilet: <i>Banka; Sigurime; Kontabilitet dhe Raportim Financiar; Qeverisje dhe Auditim dhe Politika Fiskale</i> në variantet me 60 ECTS është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimin kryesor të UET-së.</p> <p>Përgjithësisht programi i studimit MP në Financë me profilet, ka reflektuar ndryshimet në tregun e punës. Që nga akreditimi i parë i këtij programi në vitin 2011/2013 kemi zgjerimin e tregut të punës në sistemin bankar, të sigurimeve, auditimit dhe në atë fiskal ku edhe mundësitë e punësimit të studentëve që përfundojnë profilet e këtij programi janë më të mëdha.</p> <p>Programi i studimit merr parasysh zhvillimet ekonomike të vendit, që nga akreditimi i parë i tij. Periudha që nga akreditimi i parë është shoqëruar me zhvillime strukturore dhe reforma të ndërmara në sektorin e financës në kontekstin edhe të rritjes së rolit të këtij sektori. Zhvillimet ekonomike në sektorin e fiskalitetit si dhe atë të auditit janë një premisë e mundësive të aplikimeve për punësim nga specialistë të përgatitur në programe të nivelit MP në finance me profilet e mësipërme.</p> <p>Programi i studimit nuk bie ndesh me interesat kombëtare dhe cënimin e vlerave kulturore të vendit.</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>Programi i studimit MP në Financë me profilet është bazuar në strategjinë e UET dhe zhvillimin e tij. Ky program është tashmë në vitin e 8-të zhvillimit të tij. Bazuar në zhvillimet e këtyre</p>

¹ GVJ duhet të shprehen me shkrim për çdo standard në mënyrë të përmblodhur (mbështetur në kriteret majtas). Në fund të çdo rubrike, grupi duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardeve në tërësi.

6



	<p>viteve që nga akreditimi i parë, Fakulteti i Ekonomisë dhe i Teknologjisë së Informacionit dhe Departamenti i Financës dhe Ekonomiksit pranë UET-së ka bërë edhe ndryshimet e lejuara në program në funksion të strategjisë së institucionit. Këto ndryshime janë fokusuar në cilësinë e mësimdhënies, të stafit dhe vazhdimësinë e programit me të gjitha profilet e sipërpermendura. Programi bazohet tashmë në Kartën e Bolonjës që përcakton ndarjen e grupimit të lëndëve në kurrikulën e programit MP në Financë, në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira bashkëkohore. Gjithashtu, programi përfshin llojshmëri të gjerë profesionësh e specialitetësh brenda fushës së financës.</p>
--	---

Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

<p>Kriteri 1 Përmbajtja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi; Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>Programi i studimit MP në Financë me profile është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Bazuar në Vendimin e Këshillit të Akreditimit 453, date 03.05.2013 dhe Urdhërit të Ministrit Arsimit dhe Shkencës nr.233. date 06.06.2013 ky program studimi është riorganizuar nga master i nivelit të parë me tre profile në Master Profesional me pesë profile. Sipas këtij urdhëri kohëzgjatja normale e këtij program studimi do të jetë 1.5 vite akademike me 60/90 kredite. Nderkohë, që nga viti akademik 2016-2017 ky program studimi ofrohet 1 vit akademik me 60 kredite.</p> <p>Bazuar në emërtimin e programit ky program është në përputhje me orientimet e Kornizës Shqiptare të Kualifikimit. Emërtimi i profileve të programit janë në përputhje jo vetëm me drejtimin e tij në financë por drejtojnë më mirë kërkesat e specialistëve që e përfundojnë atë me ofërtën që ofron tregu i punës për specializime më të ngushta.</p>
--	---

Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.

<p>Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve; Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>Në planin strategjik të hartuar nga UET-ja janë përcaktuar edhe drejtimet kryesore të përmirësimeve për programet e vecanta që zhvillohen nga institucioni. Në këtë strategji vihet si detyrë rishikimi i programeve në mënyre periodike me së paku në intervalin e jo më shumë se një herë në dy vite.</p> <p>Bazuar në planin strategjik të institucionit që përcakton përmirësimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, Departamenti i Financës dhe</p>
---	---

7



	<p>Ekonomiksit që mbulon këtë program vlerëson ,monitoron procesin e mësimdhënies së stafit duke planifikuar vlerësim të vazhdueshëm periodik si dhe pjesëmarrjen e profesorëve apo specialistëve të ftuar në trajtimin e temave të fushës së financës dhe më gjerë.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Programi MP në Financë me profile është bazuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e UET-së. Programi MP në Financë me profile po zbatohet në përputhje me planin strategjik të UET-së si dhe të zhvillimeve në ekonominë kombëtare.</p> <p>Programi MP në Financë me 5 profile pajis studentët me njohuritë bazë teorike dhe praktike, në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira të edukimit universitar.</p> <p><i>GVJ mbeshtetur në RVB, dokumentacionin shoqërues të dosjes së vetvlerësimit të institucionit konkludon se ky program lidhur me misionin dhe objektivat e institucionit si dhe procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies i plotëson standardet plotësisht</i></p> <p><i>Rekomandim:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Për ti paraprirë zhvillimeve të ardhëshme ekonomike dhe sociale, institucioni duhet ti paraprijë këtyre zhvillimeve edhe me përgatitjen e një programi MP në Financë me profile me një numër 120 ECTS duke qenë në koherencë me Ligjin Nr 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Insitucionet e Arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.</i> 	

2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit


Universiteti European i Tiranës përbëhet nga strukturat akademike dhe administrative. Aktualisht, UET-i përbëhet nga tre fakultete: Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Edukimit, Fakulteti Juridik dhe Fakulteti Ekonomik dhe i Teknologjisë së Informacionit, të strukturuar në njësi bazë (departamente dhe qendra). Në strukturën e UET renditen edhe njësitë administrative e mbështetëse. Gjatë viteve pas akreditimit të parë, struktura organizative e UET ka pësuar ndryshime sasiore dhe cilësore. Ndryshimt sasiore shihen në angazhimin e një numri në rritje të stafit akademik në përmbushjen e programeve të ofruara, ndërsa ndryshimet cilësore shihen kryesisht në rekrutimin e një stafi të kualifikuar me grada shkencore, tituj akademik dhe eksperience mesimore shkencore. Një zhvillim pozitiv duhet theksuar se përbën edhe rritja e pavaresisë së njësive bazë mësimore shkencore sic janë Departamentet, forcimin e rolit koordinues në nivel fakulteti, si dhe përmirësimin e administrimit dhe strukturën organizative të universitetit. Autoritetet drejtuese janë Rektori, Dekani, Përgjegjësi i departamentit dhe administratori.

Programi MP në Financë me 5 profilet zhvillohet kryesisht nga Departamenti Financës dhe Ekonomiksit që është një nga tre departamentet e Fakultetit Ekonomik dhe i Teknologjisë së Informacionit pranë UET-së si më poshtë:

- Departamenti i Financës dhe Ekonomiksit
- Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut
- Departamenti i Matematikës Informatikës, dhe Statistikës.

Fakultetit Ekonomik dhe i Teknologjisë së Informacionit është dhe fakulteti kryesor i UET-së ku ndjekin studimet rreth 55% e numrit të studentëve të institucionit. Gjatë periudhës që nga akreditimi i parë ,Fakulteti dhe Departamentet u janë nënshtruar ndryshimeve të cilat kanë pasur për qëllim lidhjen më të mirë të programeve të

8



studimit, të diplomave që ofrohen me mënyrën e organizimit të tyre, me qëllim sigurimin e një cilësie sa më të mirë të programeve të studimit, në përgjigje të kërkesave të tregut

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Fakulteti, Organizimi hierarkik i Fakultetit
- Struktura akademike e Fakultetit/Departamentit

Organet dhe autoritetet drejtuese të Fakultetit Ekonomik dhe i Teknologjise së Informacionit janë: Dekani, Pergjegjesat e Departamenteve, Këshilli Shkencor i programeve. Departamenti Financës dhe Ekonomiksit është njësi bazë mësimore-kërkimore, që përfshin fushën e kërkimit në Financë, kontabilitet, bankë dhe ekonomiks duke përfshirë këto disiplina përkatëse. Parë në tërësi, mund të themi se kemi zbatim hierarkik të strukturës Universitare dhe asaj të Fakultetit dhe Departamentit me organe të përcaktuara qartë që mbulojnë fushën e kërkimit shkencor, mësimdhënies dhe atë administrative.

Fakulteti në vitin aktual akademik 2017-2018 ka në përbërjen e tij **82** personel akademik efektiv dhe me kontratë. Personel Akademik Efektiv (PAE) janë gjithsej **52** persona, nga të cilët **29** janë me tituj/grada, ndërsa Personel Akademik me Kontratë (PAK) janë gjithsej **30**, nga të cilët **19** me tituj/grada. Në aneksin e këtij raporti në tabelën nr.1 jepen të dhëna më të detajuara.

Departamenti i Financës dhe Ekonomiksit si njësi që mbulon këtë program ka patur ecurinë e zhvillimeve sasiore dhe cilësore që përmendëm më lart dhe që shprehet në të dhënat si si më poshtë:

Për vitin akademik 2014-2015 Departamenti përbëhet nga **9** (PAE) 8 me tituj/grada, dhe **18** (PAK) nga ku **9** me tituj/grada.

Për vitin akademik 2015-2016 Departamenti përbëhet nga **25** (PAE) 15 me tituj/grada, dhe **10** (PAK) 5 me tituj/grada.

Për vitin akademik 2016-2017 Departamenti përbëhet nga **22** (PAE) 13 me tituj/grada, dhe **10** (PAK) 8 me tituj/grada.


Për vitin akademik 2017-2018 Departamenti përbëhet nga **23** (PAE) 14 me tituj/grada, dhe **3** (PAK) 1 me tituj/grada.

Në përbërjen e këtij departamenti janë ngritur edhe 3 Grupe Mësimore Shkencore (GMSH) në profilet Financë, Bankë dhe Ekonomiks që mbulojnë lëndët e formimit të fushës më të ngushtë të mësimdhënies. Fakulteti ofron 4 programe studimi të Ciklit të Parë (BA); 3 programe studimi të Ciklit të Dytë Master i Shkencave (MSH), 5 programe të Ciklit të Dytë Master Profesional (MP) dhe 1 program të Ciklit të Tretë (Dr). Në këtë Fakultet ndjekin studimet rreth 54.5% e studentëve të programeve Bachelor të UET-it, rreth 53.4% e studentëve që ndjekin studimet në programet Master Profesional dhe 71% e studentëve që ndjekin studimet në programet Master Profesional që ofron universiteti. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga IAL, si dhe përmbajtja e raportit të vlerësimit të brednshëm dinamika e strukturimit akademik të fakultetit dhe departamentit është përgjithësisht e qëndrueshme, ku shihet vit pas viti rritja e kualifikimit të stafit akademik si dhe te peshës në mësimdhënie të PAE ndaj PAK.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Gjatë vizitës në institucion nga ana e GVJ u kërkua, në takimet me strukturat drejtuese të institucionit, personelin e Departamentit të Financës dhe Ekonomiksit të dhëna shtesë dhe të fundit lidhur me evolucionin e stafit të këtij departamenti. Gjithashtu GVJ u njoh edhe me procedurat e rolit të Departamentit në procesin e hartimit të programeve mësimore, kurrikulave, rekrutimit të personelit akademik gjatë vizitës në institucion etj. Të dhëna më të detajuara gjenden tek ankeset e këtij raporti shih tabelat 1 dhe 2.

9



(Të dhënat jepen në Tabelat 1,2 në Aneks)

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<p>Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.</p> <p>Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p>Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p>Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p>Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore “Doktor”.</p>	<p>Organizimi i UET-së, struktura e tij hierarkike është e ndërtuar në mënyrë të tillë që të përmbushë misionin dhe objektivat e përcaktuara prej tij por edhe të programit MP në Financë duke ju nënshtruar edhe ndryshimeve gjatë viteve pas akreditimit të parë</p> <p>Ky universitet jopublik është i organizuar në 3 Fakultete konkretisht</p> <ol style="list-style-type: none"> Fakulteti Ekonomik dhe Teknologjisë së Informacionit Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Edukimit Fakulteti Juridik <p>duke përmbushur standartin e kërkuar.</p> <p>Brenda Fakultetit Ekonomik dhe Teknologjisë së Informacionit ku ofrohet edhe programi MP në Financë me 5 profile, operojnë si njësi bazë 3 Departamente konkretisht:</p> <p>Departamenti i Financës dhe Ekonomikist</p> <p>Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut</p> <p>Departamenti i Matematikës Informatikës dhe Statistikës</p> <p>Te tre Departamentet e përfshira në Fakultetin e Ekonomisë dhe IT kanë objektiva dhe mision të përcaktuar në funksion të fushes së ekonomisë apo informacionit që ato kanë në fokus të zhvillimit të programeve. Departamenti i Financës dhe Ekonomikistit që mbulon këtë program ka të përcaktuar misionin, objektivat dhe strategjin e zhvillimit të tij. Personeli akademik i njësisë bazë i përgjigjet si kërkesave ligjore ashtu edhe nevojave të institucionit për të mbuluar ngarkesën mësimore të programeve të studimit.</p> <p>Departamenti i Financës dhe Ekonomikistit që mbulon zhvillimin e programit MP në Financë me 5 profile për vitin akademik 2017-2018 ka një personel akademik efektiv (PAE) prej 23 personash nga të cilët 14 janë me tituj/grada dhe 3 personel akademik me kontratë (PAK) nga të cilët 1 është me tituj/gradë.</p>
<p>Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.</p>	



10 

<p>Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Njësia bazë mësimore shkencore e realizimit të programit MP në Financë me 5 profile është Departamenti i Financës dhe Ekonomiksit. Departamenti operon në dinamikën e tij duke zhvilluar takime dhe diskutime të përjavshme për problematikën e mësimdhënies, kërkimit shkencor etj. Ndër funksionet kryesore të departamentit përmendim: shqyrtimin dhe miratimin e planeve mësimore, programeve të lëndëve (syllabuseve), si edhe propozimin e ndryshimeve që gjykohen të nevojshme; shqyrtimin dhe miratimin propozimeve të përgjegjësve të grup- lëndëve për tekstet mësimore që do të përdoren në lëndët e programit të studimit; ndjekjen e realizimit të programit të studimit sipas planit të miratuar dhe mbikëqyrjen e cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>Në procesin e rekrutimeve të personelit të ri akademik departamenti bën propozimet për profilin e nevojshëm të kandidatit për plotësimin e vendit vakant në përputhje me ngarkesën mësimore që ai nevojitet të plotësojë.</p> <p>Përgjegjësi i departamentit të Financës dhe Ekonomiksit është anëtar i komisionit të rekrutimit të personelit të ri akademik. Përgjegjësi i departamentit përgjigjet për vlerësimin e performancës së personelit akademik të departamentit gjatë vitit akademik. Kjo përfshin kryesisht korrektesën e tij në respektimin e orarit të punës, zhvillimin e mësimin, dhe përmbushjen e detyrimeve të tjera akademike, si edhe cilësinë e mësimdhënies në auditor.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Duke shqyrtuar dosjen e vetvlerësimit , por edhe diskutimet që u kryen gjatë vizitës në institucion si dhe dokumentacioni që u paraqit për grupin e vlerësimit të jashtëm, GVJ vlerëson se struktura akademike e Fakultetit Ekonomik dhe Teknologjisë së Informacionit, si dhe Departamentit të Financës dhe Ekonomiksit si njësi bazë e cila mbulon zhvillimin dhe administrimin e programit të studimit MP në Financë me 5 profile ,është e organizuar në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi, dhe nevojat e këtyre njësive për të realizuar me cilësi programet e studimit në këtë program.</p> <p>Numri e personelit të Departamentit të Financës dhe Ekonomiksit, cilësia akademike e tij, procesi i menaxhimit të përditshëm të programit të studimit dhe roli i kësaj njësie bazë në hartimin e programeve, rekrutimin e stafit akademik dhe vlerësimin e performancës së antarëve të njësisë plotëson plotësisht standardin e rolit të njësisë në realizimin e programit të studimit.</p> <p>GVJ konkludon se: struktura e Fakultetit të Ekonomisë dhe Teknologjisë së Informacionit dhe Departamentit të Financës dhe Ekonomiksit si njësi që mbulon këtë program i plotëson plotësisht standardet për arritjen e misionit dhe objektivat të programit.</p>	




3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Përzgjedhja e anëtarëve të personelit akademik, si dhe vlerësimi i performancës së tyre rregullohet me dispozitat përkatëse në Statutin e UET-it dhe me dokument të vecantë. Emërimi i tyre është e drejtë eskuzive e Rektorit . Të drejtat dhe detyrat e personelit akademik ngarkesa dhe format e saj përcaktohen në kontratën e lidhur mes tij dhe UET-it, bazuar në Kodin e Punës, në Statutin e institucionit, në rregulloret, në Kodin e Etikës si dhe në dokumenta të tjera të miratuara nga organet drejtuese të UET-it. Vlerësimi i performancës së stafit për mësimdhënien ka në bazë raportin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë së UET, si dhe përpunimin e pyetsorëve të studentëve që plotësohet periodikisht cdo fund semestri. Nevojat për personel të ri akademik rezultojnë pas analizës që bën departamenti, i cili ka të drejtën të bëjë paraqitjen për rekrutim personeli akademik në Këshillin e Fakultetit.

Kriteret kryesore mbi të cilat mbështetet vlerësimi/rekrutimi i kandidatave për këtë program studimi janë:

- Të diplomuar në universitetet perëndimore.
- Të ketë së paku gardë shkencore PhD ose Doktor, si dhe tituj Prof/Prof.As
- Rezultatet personale të kandidatit
- Aktivitet kërkimor e botues me objektivat e UET-it
- Zotërimi i gjuhëve të huaja
- Paraqitja gjatë leksionit të hapur para departamentit përkatës(kur aplikohet)
- Rëndësi i jepet edhe përvojës së stafit që pritet të merret në punë.

Duke filluar nga viti akademik 2016-2017 programi MP në Financë në të 5 profilet zhvillohet në variantin me 60 ETC i shtirë gjatë 1 viti kalendarik.Stafi akademik i angazhuar per programin e studimit në vitin aktual akademik **2017-2018** është **13** pedagogë gjithsej, nga të cilët **10** (PAE) dhe **3** (PAK).

Për vitin akademik **2016-2017** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka qenë **14** pedagogë gjithsej, nga të cilët **10** kanë qenë PAE, **7** me tituj/grada dhe **4** PAK, **3** me tituj/grada.

Për vitin akademik **2015-2016** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka qenë **15** pedagogë gjithsej, nga te cilet **14** kanë qenë PAE, **12** me tituj/grada dhe **1** PAK **0** me tituj/grada.

Për vitin akademik **2014-2015** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka qenë **16** pedagogë gjithsej, nga te cilet **12** kanë qenë PAE, **10** me tituj/grada dhe **4** PAK, **1** me tituj/grada.

Për vitin akademik **2013-2014** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka qenë **16** pedagogë gjithsej, nga te cilet **12** kanë qenë PAE, **8** me tituj/grada dhe **4** PAK, **2** me tituj/grada

Për vitin akademik **2012-2013** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka qenë **12** pedagogë gjithsej, nga te cilet **7** kanë qenë PAE, **7** me tituj/grada dhe **5** PAK, **0** me tituj/grada

Për vitin akademik **2011-2012** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka qenë **12** pedagogë gjithsej, nga te cilet **6** kanë qenë PAE, **6** me tituj/grada dhe **6** PAK, **1** me tituj/grada.

(Të dhënat në Tabelat 3 në Aneks

Raporti Personel Akademik / Student në këtë program per vitin akademik aktual është $13/140=0.092$, ndërsa për vitin akademik 2016-2017 është $14/112 = 0.125$

Raporti Personel Administrativ / Student në këtë program per vitin akademik aktual është $52/140= 0.37$

**Personeli administrativ është dhënë në nivel institucional pasi i shërben gjithë programeve të studimit*

Raporti PAE/PAK në këtë program per vitin akademik aktual është $10/3 =3.3$, ndërsa per vitin akademik 2016-2017 është $10/4 =2.5$

Raporti PAE/Totalit te personelit akademik në këtë program per vitin akademik aktual është $10/13 = 77 \%$, ndërsa per vitin akademik 2016-2017 është $10/14 = 71.4\%$

Raporti pedagoqeve të përfshirë në zhvillimin e këtij programi/student për vitin akademik aktual është 1 pedagog për 10 studentë të regjistruar, ndërsa per vitin akademik 2016-2017 është $112/14 = 8$

Bazuar në raportet e mësipërme, vihet re ky program për vitin akademik aktual mbulohet rreth **77 % nga staf i brendshëm PAE** dhe rreth **23%** staf i jashtëm, PAK.

Raportet e dhëna mësipërm janë të mjaftueshme për numrin e studentëve aktualë të regjistruar në këtë program, gjatë vitit akademik aktual 2017-2018 dhe 2016-2017, vit kur programi ofrohet vetem me 60 ETC.

Shihet që në total pedagoget pa grada shkencore dhe tituj akademik zënë rreth 42 % të personelit të angazhuar në këtë program.

Vlerësimi i treguesve të matshëm:

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (referohu tabelave nr.3 në Aneks, të cilat janë plotësuar edhe nga verifikimi i tabelave në RVB)**

Numri i personelit akademik efektiv (PAE) dhe personeli akademik me kontratë (PAK) janë në përputhje me dispozitat ligjore për organizimin e strukturave didaktike për programet e studimit.

Sipas dokumentacionit të paraqitur për vitin akademik 2017-2018, stafi akademik që është angazhuar në këtë program studimi përbëhet nga **13 pedagogë** gjithsej, nga të cilët **10** janë personel akademik efektiv (PAE), dhe **3** personel akademik me kontratë (PAK). Në dy vitet e fundit akademik programi është zhvilluar vetëm me 60 ECTS. Shihet prirja drejt mbulimit të procesit mësimor në këtë program me staf akademik efektiv PAE.

- Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinator/ët e programit të studimit**

Këshilli Shkencor i Programit të studimit sipas RVB dhe verifikimit të vizitës në institucion përbëhet nga 4 anëtarë dhe koordinatori i programit të studimit.

(Tabela nr 4 në aneks).

- Të dhënat sipas seksit dhe sipas moshës së personelit jepen (Tabela 5 në Aneks)**

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Bazuar në RVB si dhe gjatë vizitës në institucion personeli akademik (PAE, dhe PAK) si dhe personeli administrativ, janë të pajisur me kontrata pune që ruhen në zyrën e burimeve njerëzore. Ato kanë të përshkruar detyrimet dhe të drejtat e secilës palë që e nënshkruan. Ne u njohëm me kontratën tip të punësimit si dhe vlerësuam me zgjedhje disa kontrata individuale të stafit akademik dhe mbështetës, në dy sistemet, full time dhe part time. Këto kontrata ishin konform legjislacionit të punës. Personeli kishte njohuri mbi të drejtat dhe detyrat që lindin nga zbatimi i kontratës, si dhe rastet kur pedagogu i brendshëm apo i jashtëm kishte angazhime të tjera jashtë UET-it.

Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se stafi ndihmës dhe administrativ u shërbente të gjithë programeve në UET. Angazhimi i tyre ishte serioz në mbarëvajtjen e procesit mesimor dhe shkencor në institucion. Rekrutimi i stafit ndihmës/administrativ për Departamentin, bazuar në dokumentacionin e paraqitur ishte sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, por edhe standardeve të punësimit në UET.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;	<p>Bazuar në objektivat e programit MP në Financë me 5 profile, vërehet angazhim serioz i personelit akademik për përmbushjen e tyre. Në syllabuset e miratuara të këtij programi janë shprehur qartë objektivat e mësimdhënies si dhe temat përkatëse për secilën prej moduleve të miratuara. Programi zbatohet tërësisht dhe ka një kordinim të personelit akademik me atë ndihmës dhe administrative. Leksionet e zhvilluara nga personeli akademik respektojnë tërësisht programin/ syllabusin e miratuar duke marrë parasysh edhe lirinë akademike të titullarit të modulit përkatës. Kontakti me dokumentacionin bazik rregullator që është i aksesueshëm nga secili përmes publikimit virtual në LMS në një folder të vecantë.</p> <p>Vlerësimi i performancës së personelit akademik bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe kontrollohet vazhdimisht nga Komisioni për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë(KSBC), i cili bën edhe rekomandimet e nevojshme për përmirësimin e kërkuar, në përputhje me objektivat, strategjinë dhe aktet rregullatore në fuqi. KSBC harton cdo vit planin e veprimit të sigurimit të cilësisë i cili përfshin komponentin e mësimdhënies, veprimtarisë shkencore dhe administrimit të cilësisë. Nga vlerësimi që ne i bëmë këtij plani të marrë gjatë vizitës në institucion, mendojmë se është i plotë dhe</p>
Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	

me ndikim në përgjegjësinë e stafit akademik në rritje të cilësisë së komponenteve.

Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.

Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;

Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Gjatë vizitës në insitucion nga takimi me personelin akademik , konstatuam që ai është përfshirë intensivisht në përgatitjen e programit kryesisht nëpërmjet përgatitjes së syllabusve për cdo modul dhe në funksion të tyre edhe të kurrikulës së programit. Kurrikulat e programeve diskutohen gjerësisht në mbledhjet e Departamentit të Financës dhe Ekonomiksit ku ftohen edhe antarë të Bordit të Tregut të Punës.Vendimet për hartimin dhe rishikimin e kurrikulave merren me propozim të njësisive bazë, departamenteve. Çdo anëtar i departamentit ka të drejtë të bëjë propozime dhe të argumentojë përpara kolegëve ndryshimet e propozuara. Nëse vendimi miratohet në nivel departamenti kalon për miratim në instancat më të larta të Këshillit të Fakultetit e më pas në Senatin Akademik. Për një rol më të rëndësishëm të personelit akademik dhe për një rritje cilësore të programit mendojmë qe roli i Grupeve Mësimore Shkencore të Departamentit duhet të jete më i fuqishëm pasi janë antarët e çdo GMSH-je që kane kompetenca profesionale më të mëdha në përcaktimin e lëndëve të kurrikulës dhe përmbajtjes së syllabusve përkatëse. Gjithashtu, shqyrtimi i kurrikulës së programit dhe përmbajtjes së syllabusit duhet ti nënshtrohet një diskutimi më të gjerë dhe të hollëishëm në mënyrë që të eliminohen sa më shumë mbivendosjet në trajtim që mund të rezultojnë për disa lëndë

UET- ja ka një kuadër rregullativ të brendshëm mbi të cilin mbështetet procesi i punësimit të personelit akademik efektiv dhe me kohë të pjesshme.

Kriteret shpallen publikisht dhe përzgjedhja bëhet me konkurs. Ne verifikuam me zgjedhje të rastësishme disa praktika rekrutimi të personelit akademik dhe vlerësojmë zbatimin e kuadrit rregullativ të brendshëm tëUET-së. Në Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe në Zyrën e Arkivit gjenden dosje të aplikantëve për punë, të komisioneve të intervistimit, vlerësimit të kandidatëve dhe njoftimeve për punë.

Personeli i angazhuar në programet e ciklit të dytë realizon ngarkesën mësimore sipas akteve në fuqi

	<p>dhe kontratës së lidhur me UET-in. Si rregull pedagogët me grada e tituj duhet të plotësojnë ngarkesën fillimisht në ciklin e dytë dhe nuk mund të zhvillojnë më shumë se 4 lëndë në vit. Nga vlerësimi i ngarkeses mësimore të tre viteve të fundit vumë re se nuk kishte disporpocion të theksuar mes pedagoqeve të angazhuar në program.</p>
<p>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoti se procedurat për rekrutimin e stafit akademik mbështeten në kuadrin ligjor ne fuqi lidhur me rekrutimin e personelit si dhe në aktet e brendshme rregullative të institucionit në këtë fushë. Kriteret shpallen publikisht duke ofruar transparencën në treg. Vlerësimi i kandidatëve për punësim realizohet me system pikëzimi dhe nëpërmjet konkurimit.</p> <p>Nëse shohim evolucioni gjatë viteve të fundit lidhur me rolin në mësimdhënie të PAE dhe PAK, vemë re prirjen drejt përballimit të ngarkeses akademike me PAE.</p> <p>Programi MP në Financë m 5 profile, aktivizon së paku 70% të personelit akademik me kohë të plotë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Për vitin 2015-2016 rezulton se 93% e programit është mbuluar nga PAE • Për vitin 2016-2017 rezulton se 74% e programit është mbuluar nga PAE • Për vitin 2017-2018 rezulton se 77% e programit është mbuluar nga PAE <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ verifikoi se vlerësimi i personelit akademik realizohet në mënyrë periodike nëpërmjet 3 mënyrave:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimit nga titullari i Departamentit; • Vlerësimit nga studentët, nëpërmjet pyetsorit on – line dhe vlerësimit me Fokus Grupe • Vlerësimit nga drejtuesit e UET në fund të vitit akademik (procesi follow-up). <p>Nga verifikimi i disa dosjeve të personelit akademik GVJ verifikoi që në këto dosje ishin skedat e vlerësimit periodik që janë realizuar nëpërmjet 3 metodave të përmendura më lart.</p> <p>Institucioni mban bazën e të dhënave për rekrutimin e stafit në Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe në Zyrën e Arkivit, ku gjenden dosje të raporteve të rekrutimit të</p>

	<p>personelit si dhe njoftime për vende vakante. Gjithashtu për çdo vend vakant njoftimet bëhen në faqjen zyrtare të universitetit dhe në gazetën Mapo.</p>
<p>Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.</p>	
<p>Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p>Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p>Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>Aktualisht përgjegjësi i programit, i cili është njëkohësisht edhe përgjegjës i departamentit ka titullin Prof. Asoc. Dr.</p> <p>Nga verifikimi i dokumentave që këruam gjatë vizitës në institucion rezultoi se të gjithë titullarët e lëndëve të angazhuar në zhvillimin e programit të studimit janë pedagogë me grada dhe tituj për vitin aktual (1 me titull Profesor Doktor, 4 me titull Profesor i Asociuar, 5 me gradë shkencore Dr dhe 3 asistentë lektor).</p> <p>Në tre vitet e fundit ngarkesa e programit është realizuar mbi 80% nga pedagogë të brendshëm.</p> <p>Autoritetet drejtuese të institucionit janë të punësuar me kohë të plotë, në bazë të kontratës së punës të lidhur mes palëve, nuk u lejohet asnjë angazhim tjetër me kohë të plotë në insitucione të tjera.</p> <p>Stafi akademik i angazhuar në këto program ka një numer total prej 13 pedagogësh dhe e ka të pamundur të mbulojë praktiken profesionale të studenteve (bazuar në raportin studente /staf akademik që është $13/140 = 9$ student, që duhet të mbikëqyr një pedagog . në këto kushte Departamenti i Financës & Ekonomiksit ka angazhuar personel shtese për mbikëqyrjen e praktikave profesionale, të cilët kanë gradën doktor e lart. Në ndihmë të studenteve për gjetjen e institucionit përkatës, departamenti ka bashkëpunuar me Zyrën e karrierës, në bazë të lidhjeve të saj me insitucione të ndryshme financiare.</p>
<p>Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e</p>	<p>Departamenti i Financës dhe Ekonomiksit si njësi bazë që mbulon zhvillimin e programit MP në Financë me 5 profile përcakton edhe udhëheqësit shkencor për punimet e mikrotezës për çdo student të programit. Gjithashtu pedagogët udhëheqës të punimeve organizojnë takime periodike me studentët lidhur me ecurinë e realizimit të punimit duke synuar realizimin e një punimi sa më cilësor.</p> <p>Duke iu referuar RVB dhe vizitës në insitucion, në</p>


<p>studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>departamentin e Financës dhe Ekonomiksit udhëheqësi i tezave kishte gradë shkencore Dr ose titull akademik. Bazuar në numrin e personelit akademik të angazhuar në këtë program por edhe të gjithë personelit akademik të Departamentit të Financës dhe Ekonomiksit dhe numrit të studentëve të regjistruar dhe diplomuar në këtë program <i>ky kriter nuk përmbushet.</i></p> <p>Nga verifikimi i bere gjatë vizitës në institucion rezulton mosplotesimi kriterit te numrit te studenteve ne udheheqje per cdo pedagog pasi ne disa raste ky numer varion nga 10 studente deri në 15 studentë.</p> <p>Mendojmë që për plotësimin e këtij kriteri krahas shtimit të personelit akademik të Departamentit të Financës dhe Ekonomiksit duhet të angazhohen si personel akademik nga Departamentet e tjera (që mund të jenë pranë fushës së studimit) por edhe personel akademik i jashtëm. Kjo do të rrisë më tej cilësinë e punimeve përmbyllese të këtij programi.</p>
--	--

Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.

<p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Bazuar në kërkesën e studentëve dhe propozimin e tyre të fushës së punimit të mikrotezës në Departament përcaktohen edhe udhëheqësit shkencor për kandidatët. Miratimi i listës së udheheqësve shkencor për cdo student u bëhet e ditur këtyre të fundit nëpërmjet shpalljes publike.</p> <p>Për vetë faktin e nivelit të kualifikimit të personelit akademik udhëheqësit e punimeve të studentëve të programit kanë kompetencat kërkimore për te realizuar këtë fazë përmbyllese të programit nga studentët. Mendojmë që për arsye të numrit të lartë të studentëve që udhëheq, dhe të diversitetit te mundshëm të temave të fushës përkatëse të studimit lindin problematika në realizimin me sukses të këtij procesi. Në këto kushte, angazhimi si udheheqës të një numri studentësh të programit nga kademikë të jashtëm që janë njëkohësisht te specializuar në këto profileve, do rriste cilesine e mbikeqyrjes se praktikave profesionale. Kjo mund të sjellë kosto shtesë për institucionin por do te japë përfitime të tjera si për studentët ashtu edhe për vetë institucionin.</p>
---	--

Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.

18



<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Stafi i Zyrës së IT-së, i angazhuar për mirëmbajtjen e laboratorëve të informatikës, dhe pajisjeve ndihmëse në auditore ka kualifikimin e duhur dhe është në dispozicion të studentëve dhe pedagogëve përgjatë gjithë kohëzgjatjes së zhvillimit të mësimi. Gjithashtu personeli administrativ është gjithmonë në shërbim të studentëve dhe personelit akademik për të siguruar mbarëvajtjen e procesit akademik.</p> <p>Për të siguruar zhvillimin e rregullt dhe cilësor të praktikave profesionale në UET funksionon Zyra e Karrierës dhe Praktikave, e cila ka lidhur memorandume bashkëpunimi me shumë institucione publike dhe kompani private duke mbajtur komunikim të vazhdueshëm me ta, për të garantuar akomodimin e studentëve në këto institucione. Institucioni kujdeset për përdorimin optimal të burimeve njerëzore në funksion të realizimit të objektivave të programit, duke vendosur standarde për shpërndarjen e ngarkesës mësimore, dhe balancimin mes mësimdhënies dhe detyrave të tjera të personelit akademik.</p>
---	--

Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

<p>Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit MP në Financë me profile, realizon ngarkesën mësimore sipas parashikimeve të kontratës së punës dhe akteve rregullatore të institucionit.</p> <p>Nga ana tjetër, ngarkesa mesimore ku përfshihet edhe ngarkesa jashtë auditorit shpesh është e lartë pasi një pjesë e mirë pedagogëve kanë një numër të lartë udhëheqje punimi diploma apo mikroteze rrjedhojë kjo e faktoreve të shpjeguar më lart.</p> <p>Ngarkesa mësimore është planifikuar në bazë të orëve mësimore, të cilat për nivelin e studimit master kanë një koeficient 1.25 me orën fizike. Kontrata e punës përcakton edhe elementët e tjerë të ngarkesës mësimore, si udhëheqjet e oponentat e diplomave dhe konvertimin e tyre në orë mësimore njësi.</p> <p>Për ngarkesën e stafit në të gjitha programet e studimit për vitin akademik 2017-2018, në dokumentacionin e sjellë nga institucioni rezultojnë:</p> <p>Stafi PAE:6 pedagogë mbulojnë 4 lëndë, 3 pedagogë mbulojnë 3 lëndë, dhe 1 pedagog mbulon 1 lëndë. Ngarkesa orë në auditor paraqitet: nga 52.5 deri në 304.5.</p> <p>Stafi PAK:1 pedagog mbulon 3 lëndë, 1 pedagog mbulon 2 lëndë, dhe 1 pedagog mbulon 1</p>
--	--

lëndë.Ngarkesa orë në auditor paraqitet:nga 65.5 deri në 71.25.

Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.

Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;

Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;

Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.

Bazuar në dokumentat bazë të funksionimit të UET, departamentet për programet e studimit dhe lëndët që menaxhojnë, si dhe Zyra e Burimeve Njerëzore në nivel institucional, mbajnë të dhëna të detajuara në lidhje me personelin akademik të angazhuar në mësimdhënie, formën e punësimit, si dhe ngarkesën që mbulon cdo pedagog.

Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik efektiv dhe me kontratë për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor- shkencor dhe atij administrativ;.

Kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik përcaktohen me dokument dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik, të vecantë pjesë e broshurës së dokumenteve të UET dhe publikohen në faqen zyrtare në Internet të Universitetit .

Konkluzionet e vlerësimit:

Personeli akademik dhe mbështetës i programit MP në Financë me 5 profilet i **plotëson kryesisht standardet e këkuara lidhur me**

- a. Përbushjen e objektivave të programit MP në Financë me profile dhe angazhimeve në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.
- b. Personeli akademik me grada shkencore dhe tituj akademikë mbulon përgjithësisht nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë
- c. Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.
- d. UET-ja ndjek procedura të qarta dhe transparente për rekrutimin e stafit akademik.

Rekomandime:

1. Për një rol më të rëndësishëm të personelit akademik dhe për një rritje cilësore të programit mendojmë që roli i Grupeve Mësimore Shkencore të Departamentit të jetë më i fuqishëm, pasi janë antarët e çdo grupi mësimor shkencor që kanë kompetenca profesionale më të mëdha në përcaktimin e lëndëve të kurrikulës dhe përmbajtjes së syllabusve përkaëse. Gjithashtu, shqyrtimi i kurrikulës së programit dhe përmbajtjes së syllabusit duhet të nënshtrohet një diskutimi më të gjerë dhe të hollësishëm në mënyrë që të eliminohen sa më shumë mbivendosjet në trajtim që mund të rezultojnë për disa lëndë.
2. Në kushtet kur numri i studentëve të regjistruar gjatë viteve të fundit apo edhe aktualisht në programin MP në Financë me profile është i konsiderueshëm, institucioni duhet të gjejë rruget e plotesimit të kriterit optimal të numrit të studenteve të programit për një pedagog udheheqës. Plotësimi i këtij standardi duhet të realizohet si nepermjet rritjes të personelit akademik të Departamentit të Financës dhe Ekonomiksit edhe nëpërmjet angazhimit të personel akademik nga Departamentet e tjera apo edhe personel akademik i jashtëm (PAK). Nje alternative tjetër është edhe realizimi i mbrojtjes me provim për nje numer studentesh bazuar ne kriterin e notes mesatare.

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

20

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

UET-ja vazhdon të zhvillojë veprimtarinë e saj në të njëjtën vendndodhje ku edhe ka nisur aktivitetin para 10 vitesh. Sipërfaqja totale e godinave të Universitetit është rreth 10,000 m². Përreth godinave, ndodhet një hapësirë e gjerë për lulishte me stola të jashtëm, si dhe vend për parkim për rreth 120 makina. Veprimtaria e UET-së zhvillohet në 3 godina; A dhe B si godina ku realizohet procesi i mësimdhënies dhe godina më vete e bibliotekës së institucionit. Gjithashtu, godinat ishin të pajisura me mjetet e nevojshme për mbrojtjen kundra zjarrit si vijon: një fikse zjarri në çdo kat, dhe nga një fikse zjarri në burime potenciale zjarri, në total 30 copë, si edhe sistemin e mbrojtjes kundër shkarkesave atmosferike, përkatësisht rrufe-pritëse. Mjediset ishin të kompletuara me sistemin e ngrohjes të tipit “fan cool”, me komandim qendror.

UET ka aktualisht në përdorim 4 laboratorë mësimorë informatike, përkatësisht Lab 205 B me 25 PC dhe video projektor; Lab 206 B me 35 PC dhe video projektor; Lab 207 B me 35 PC dhe video projektor; Lab 208 B me 80 pc (laboratori i internetit) dhe 33 salla mësimore, (leksione dhe seminare) të gjitha të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektore dhe foni në rastin e sallave të leksionit. Biblioteka njëkohësisht ishte e paisur me 14 pc në mënyrë që studentët të kishin mundësi të lexonin on-line.

Ambientet universitare ishin të mbuluara me sinjal Wi-Fi në mënyrë që studentët të aksesonin lirisht webin. Të gjitha klasat mësimore ishin të pajisur me pajisjet audio vizive të nevojshme për zhvillimin normal të procesit mësimor.

UET ka investuar në sisteme të cilat e mbështesin studentin në procesin mësimor. Më konkretisht në sistemin MOODLE(UET LMS) ky sistem bën të mundur që studenti në kohë reale të azhurnohet me materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shtesë audio vizive etj.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset për Programin e studimit

Bazuar në dokumentacionin e institucionit, raportin e vlerësimit të brendshëm, si dhe nga verifikimi që u bë gjatë vizitës në institucion rezultoi se UET ka në dispozicion për të gjithë programet e studimit tre godina:

- Godina A është e përbërë nga 4 kate, ku çdo kat ka një sipërfaqe prej 1000m².
- Godina B është e përbërë nga 4 kate, ku çdo kat ka një sipërfaqe prej 1000m².
- Godina C (biblioteka) gjithsej 300m². Këto sipërfaqe janë të ndara në salla leksionesh, gjithsej 10 salla me sipërfaqe totale 1510m² dhe 1515 vende.
- Salla seminari janë gjithsej 14, me sipërfaqe 45m² dhe secila me nga 35 karrige.
- Salla 70 vendeshe (leksione + seminare) janë gjithsej 9 salla me sipërfaqe 100m² secila.
- Salla për departamentet janë gjithsej 8 ambiente me sipërfaqe 45m² secila.
- Salla për laborator informatike janë 3 salla me sipërfaqe 45m² secila me kapacitet 35 vende.
- Sallë interneti me sipërfaqe 165m² me 80 kompjutera.
- Salla për bibliotekën ka sipërfaqe 300m², 150 vende leximi.
- Mjedisi për fotokopje dhe librari ka sipërfaqe 150m².
- Mjedisi çlodhes për kafe/fast-food/etj është në një sipërfaqe të vetme.
- Nyje hidrosanitare janë gjithsej 48 me sipërfaqe 300m².

- Mjedise për aktivitetet e qeverisë studentore janë 3 me sipërfaqe 140m².
- Zyra për dekanin/zv.dekanin/kancelarin janë 5 me nga 20m².
- Zyra për përgjegjës departamenti janë gjithsej 8 ambiente me nga 18m².
- Zyra për kordinatore janë gjithsej 6 ambiente me nga 14m².
- Zyra për pedagogët janë 30 me sipërfaqe 14m² secila dhe një sallë e madhe me sipërfaqe 150m², me 32 poste pune.
- Zyra për sekretarinë mesimore janë 3 me sipërfaqe 140m².
- Zyra për stafin akademik dhe administrativ janë 12 me sipërfaqe 350m²
- Zyra informacioni për studentët janë 2.
- Korridore plus holle janë gjithsej 8 me 150m² secili.500m²

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p>Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p>Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron</p> <p>;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>UET vazhdon të ketë të njëjtën vendndodhje që nga krijimi i tij në Shtator 2007, në Bulevardin. Gjergj Fishta, Nd. 70, H.1. Për veprimtarinë e UET-së janë në funksion tre godina, përkatësisht Godinat A dhe B ku zhvillohet procesi mësimor dhe Godinën C ku ndodhet Biblioteka. Pozicioni i vendndodhjes dhe hapësirat infastrukturore janë optimale dhe të paisura mire në funksion të procesit mesimor shkencor.</p> <p>Institucioni ka afro 10 vjet që ka të njëjtën vendndodhje dhe infrastruktura e tij është përmirësuar vazhdimisht duke ofruar hapësira të nevojshme dhe komode.</p> <p>Zhvillimi i procesit mësimor të programit realizohet në dy godinat A dhe B që ndodhen pranë njëra-tjetrës. Gjithashtu për një shfrytëzim optimal të infrastrukturës në dispozicion, mësimi në ciklin e dytë të studimeve zhvillohet kryesisht nga e mërkura në të premte, 17:00-20:00 dhe të shtunave 9:00 – 16:00. Kjo lehtëson pjesëmarrjen e studenteve në procesin mesimor pasi një pjesë e rëndësishme e numrit të studenteve të këtij program janë në marredhenie pune.</p> <p>Institucioni zoteron mjedise të pershtatshme lidhur me punimet informatike duke ofruar salla laboratore të informatikes për studentet.</p>
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	




Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;

Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;

Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;

Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;

Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.

Për realizimin e këtij programi institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse. Në përgjithësi tekstet bazë janë në gjuhë të huaj (kryesisht anglisht). Për disa nga lëndët ka teks ndërkombëtar universitar i përkthyer nga autorë të njohur sidomos në fushën e bankave tregjeve financiare etj. Për disa lëndë ka dhe literaturë mbështetëse.

Megjithatë për vetë vështirësitë që ka përdorimi i tyre rrjedhë e diferencave në ambientin ekonomik të vendit tonë me vendet e origjinës së librave të botuara, përdorimi i literaturës në shqip nga autorë vendas është i mangët. Bazuar në vizitën që ne bëmë në bibliotekë thuaj se mungojnë botime të autorëve vendas në disiplina bazë apo edhe në ato me zgjedhje

Nga vizita pranë bibliotekës së UET rezulton që hapësira e saj është optimale me rreth 170 vende leximi. Bazuar në listën e inventarit të librave në fushën e ekonomisë biblioteka ofron rreth 1100 tituj librash në shqip dhe anglisht që janë në ndihmë të studentëve.

Megjithatë, GVJ mendon që fondi i librave në shqip në dispozicion të studentëve duhet të ishte më i madh.

Duke u mbështetur në lëndët që zhvillohen në programin MP në financë me 5 profile rezulton se ka mangësi në alternative të literatures lidhur me këto lëndë.

Pavarësisht se titullaret e lëndëve e bazonin mësimdhënien në shumicën e lëndëve që zhvillohen në tekste të huaja dhe cilësore si dhe në prezantimet e tyre që i vinin në dispozicion, numri i teksteve alternative të lëndëve ishte i kufizuar si në titujt në anglisht ashtu edhe në shqip.

Duke pasur parasysh që studentet e programit MP në Finance me 5 profile nuk e kanë të detyrueshme dhënien e testeve ndërkometare të gjuhës së huaj, lind nevoja e shtimit të titujve të librave në shqip në librari. Pasurimi i fondit të bibliotekës me tituj librash në shqip dhe anglisht do pasuronte më tej fondin e bibliotekës dhe do u vinte në ndihmë studentëve.

Referuar RVB Biblioteka e UET është abonuar me mjaft botime periodike. Institucioni mbështet gjetjen e burimeve on-line të kërkuara nga pedagogët dhe studentët. Botimet periodike në shqip janë 359 tituj, me numra të ndryshëm dhe 61 tituj të huaj (anglisht,

frëngjisht). Biblioteka ka siguruar akses në burime ndërkombëtare elektronike për artikuj dhe libra shkencorë si: EBCSO, Questia, Social Science Library, Elsevier. Biblioteka e UET është pjesë e sistemit COBISS (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online). COBISS.Net është një rrjet ku janë të përfshira të gjitha vendet e rajonit të Europës Juglindore, e cila përfaqëson një model organizativ të lidhjes së bibliotekave në sistemin kombëtar të informacionit bibliotekar me katalogim të përbashkët, me bazën bibliografike (katalogun) të përbashkët të të dhënave dhe me bazat lokale të bibliotekave pjesëmarrëse.

Referuar RVB dhe nga takimi në Departament pamë se ai harton një plan të shtimit të fondit të bibliotekës në mbështetje të programeve, por që për realizimin e tij e cila është pjesë funksionale e strukturave të tjera nuk ka mundësi të zbatimit të plote të tij.

Orari i bibliotekës është i përshtatur sipas programeve të studimit dhe nevojave të studentëve. Që filon: nga e Hën e-Premtë 9:00-20:00 e Shtunë 9:00:17:00. Kurse gjatë sezonit të provimeve është me orar të zgjatur.

Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.

Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;

Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;

Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;

Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.

UET ka aktualisht në përdorim 3 laboratorë mësimorë informatike, të cilët janë të pajisur me PC, video projektor dhe mjete audio vizive, të cilat janë të përshtatshme për numrin e studentëve që i përdorin ato. Të gjitha sallat mësimore janë të pajisura me PC dhe mjete audio vizive të cilat vijnë në ndihmë si studentëve ashtu edhe stafit akademik.

Ambjentet universitare janë të mbuluara me sinjal Wi-Fi internet në mënyrë që studentët të aksesojnë webin. Pajisjet dhe programet e instaluar janë risitë e kohës në fushën e teknologjisë së informacionit.

Të gjithë laboratorët janë të pajisur me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor. Në PC-të e laboratorëve janë instaluar programet kompjuterike sipas kërkesave të programeve të studimit, dhe lëndëve specifike.

UET në kuadër të praktikave profesionale ka akomoduar një numër kërkesash të studentëve për të zhvilluar praktikën në njësi të ndryshme administrative si: Biblioteka, Libraria, Zyra e Kujdesit ndaj Studentëve. Zyra e Karrierës dhe Praktikave, Zyra e Aktiviteteve etj pranë koordinatoreve të

departamenteve.

Konkluzionet e vlerësimit:

Mjediset e zhvillimit të veprimtarisë së institucionit dhe programit MP në Financë me profile janë te përshtatshme dhe funksionale për zhvillimin normal të procesit mësimor, me sistem kondicionimi dhe sistem wireless. Sallat e leksionit janë organizuar në formë amfiteatri dhe me sistem fonie. Çdo sallë mësimore është e pajisur me PC dhe projektor. Laboratorët e informatikës janë të pajisura me programet e nevojshme të përcaktuara në programin mësimor. Personeli akademik i brendshëm me grada është i akomoduar në zyra dyshe. Përgjegjësit e departamenteve, dekanët, zv. Rektorët dhe drejtuesit e tjerë janë akomoduar në zyra individuale. Në dispozicion të departamenteve janë sallat e mbledhjeve. Biblioteka funksionon me orar të gjatë dhe ofron kushte të mira. Fondi i bibliotekës ofrohet në formën e hard copy dhe elektronike, në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaja në mbështetje të studentëve. Në UET funksionon sistemi i menaxhimit të mësimdhënies online (UET LMS) që është një sistem bashkëkohor.

GVJ vlerëson se infrastruktura që është në dispozicion të zhvillimit të procesit mësimor plotëson kryesisht standardet dhe kriteret e cilësisë.

Rekomandime:

Pavarësisht se ka zhvillime pozitive nëpërmjet aksesit në burime ndërkombëtare elektronike për artikuj dhe libra shkencorë si: EBCSO, Questia, Social Science Library, Elsevier, apo përkthime nga univeriteti të disa teksteve bazë të njohura, fondi i titujve të librave/teksteve në shqip kryesisht të autorëve vendas në fushen e finances, banks, sigurimeve, kontabilitetit eshte i i kufizuar vetem ne pak tituj.

5. Fincimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore



Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare është një komponent i rëndësishëm që siguron mbarëvajtjen e procesit mësimor. Burim kryesor financimi janë tarifatat për dhe gjatë shkollimit si dhe të ardhura të siguruar nga aktivitetet tregtare (qeradhenie, parkim etj.) Një zhvillim pozitiv në këtë drejtim gjatë 3-4 viteve të fundit janë burime financiare të siguruar nëpërmjet kontributeve dhe granteve për kërkim dhe kontratat në kuadër të projekteve ku institucioni është pjesëmarrës dhe përfitues.

Universiteti Europian i Tiranës kryen kontroll dhe audit çdo vit. UET shpik përmbush kuotat për kryerjen e një ekspertize, çdo vit hartohet një raport në lidhje me transparencën financiare. Për pasqyrat financiare të çdo viti audituesi i pavarur ose audituesi ligjor ka dhënë opinionin në lidhje me pozicionin financiar, performancën dhe përputhjen me standardet e kerkuara të kontabilitetit. Pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë në të gjithadrejtimet aspektet materiale, si dhe rezultatin e operacioneve të saj dhe rrjedhjes së parasë për vitin e mbyllur.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje sipas Tabelës 8 në RVB):

 25 

Të ardhurat nga:	Viti (2014)	Viti (2015)	Viti (2016)
Grandet për kërkim dhe kontratat	3.033.080	7.607.575	19.984.477
Tarifat për dhe gjatë shkollimit	645.120.809	679.213.964	735.953.246
Aktivitetet tregtare (qeradhenie, parkim etj.)	39.006.924	127.723.768	104.950.864
SHUMA	687.160.813	814.545.307	860.888.586

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje sipas RVB)

Shpenzimet për studentët që ndjekin programet e studimit për tre vitet e fundit akademike janë:

Viti akademik	Nr. studentëve	Kosto për student (lekë)
2014-2015	3.428	175.980
2015-2016	4.149	165.100
2016-2017	4.066	182.500

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
<p>Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>UET ka raport auditit çdo vit. Raportet përmbajnë transparencë në lidhje me kontabilizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe kategorizimin në llogaritë perkatese, shfrytëzimin dhe eficienten e të ardhurave për funksionimin dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve për studentët.</p>
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operationale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të</p>	<p>Institucioni bën një auditim të përvitshëm të situatës financiare të tij. Për secilin vit akademik institucioni harton raportin në lidhje me koston për secilin program studimi për të kontrolluar më lehtë ecurinë dhe vazhdimësinë konform rregullave dhe standardeve.</p> <p>Bazuar në numrin e studentëve të regjistruar</p>

studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.

gjatë gjithë viteve pas akreditimit të parë në programin MP në Financë me profile që duhet konsideruar i kënaqeshëm, si dhe në nivelin e tarifës që ata paguajnë për këtë program mendojmë se kjo siguron qëndrueshmërinë financiare të programit të studimit. Njëkohësisht ky fond i siguruar i jep mundësi institucionit që të rrisë mundësinë e investimeve në shërbim të rritjes së shërbimeve për studentet dhe infrastruktures së institucionit.

Konkluzionet e vlerësimit:

Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare i plotëson plotësisht standardet e kërkuara

UET respekton standardin e hartimit të raportimit financiar dhe të evidentimit të kostos së studimit. Pasqyrat financiare përmbajnë transparencë në lidhje me kontabilizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Zhvillim pozitiv për institucionin është rritja e burimeve financiare nga grantet apo kontributet si pjesëmarrës në projekte kërkimore shkencore dhe konsulence.

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë që nga Janari i vitit 2011 është institucionalizuar si strukturë organizative në UET nëpërmjet ngritjes dhe operimit të njësisë së përherëshme; Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC). vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore e kërkimore, administrative e financiare të UET-it. Ai ka akses në të gjitha të dhënat e institucionit.

Vlerësimi i kësaj njësie të brendshme të institucionit gërshetohet me përfshirjen e eksperteve të jashtëm në këto proces. Ngritja e organeve këshilluese si Bordi i Besimit dhe Bordet e Tregut të Punës i përgjigjet gjithashtu nevojës së institucionit për t'u konsultuar me aktorë të jashtëm. UET ka arritur të sigurojë përfshirjen si partner në dy projekte europiane që kanë në fokus sigurimin e cilësisë së brendshme nga institucionet e arsimit të lartë (projekti TEMPUS "ENCHASE" dhe Erasmus+: QAINAL)

Veprimtaria e kësaj zyre bazohet në planin kalendarik të veprimtarisë së përvitshme, në të cilin programohen kontrollat në sektorët apo proceset që i nënshtrohen kontrollit dhe që shoqërohen me raportet me gjetjet përkatëse. Ndërkohë, në mënyrë periodike KSBC informon drejtuesit e fakulteteve, e përmes tyre të gjithë stafin e UET-it rreth rezultateve të kontrolleve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njësisë së tij bazë dhe individëve në të ardhmen.

Në takimin e realizuar me antare të kësaj njësie doli që fokusi i KSBC-së është edhe:

- Formatizimi i syllabuseve (nga ana teknike)
- Monitorimi i zhvillimit të provimeve
- Kërkimi shkencor, aktivitetet që zhvillon stafi akademik, botimet, trajnimet
- Monitorimi i përmbushjes së standardeve në tërësi

Kjo njësi përbëhet nga 11 antarë (Tabela 6 tek Aneksët)

Pjesë e rëndësishme e veprimtarisë së kësaj njësie është edhe vlerësimi i performancës së stafit. Ky vlerësim materializohet në skedën e vlerësimit të miratuar nga institucioni në bazë të vlerësimeve të të gjitha rubrikave me pikë. Mbi bazën e këtij vlerësimi hartohet raporti përkatës i cili i dërgohet instancave më të larta dhe pjesë të tij i dërgohen Departamentit. Kërkesat në rritje për një cilësi sa më të lartë dhe përvoja e fituar në vite kanë shtruar nevojën për një transparencë në tërë proceset akademike që realizohet përmes paraqitjes në Intranet të programeve të lëndëve dhe dokumentacionit që lidhet ngushtësisht me procesin akademik në UET. Në këtë kuadër, për secilin program lënde që është pjesë e programeve të studimit është konceptuar një format standard, ku theksi është vendosur në paraqitjen e detajuar të çështjeve që do të mbulojnë temat që trajton lënda, si dhe të literaturës përkatëse, të detyrueshme dhe plotësuese, literaturë e cila përzgjidhet me kujdes pas një konsultimi të gjerë me ekspertë të fushës përkatëse dhe diskutimit sipas grup-lëndëve dhe në departament. Një nga format më të përdorura mbi cilësinë në UET është pyetësi me studentët, i cili organizohet dy herë në vit, në përfundim të çdo semestri, për të gjitha programet e studimit, për të gjitha ciklet, për të gjitha lëndët dhe pedagogët. Skedat e pyetësorëve përpunohen përmes programit të përdorur për vlerësimin online dhe i vihen në dispozicion të drejtuesve të institucionit, si edhe në mënyrë të personalizuar për secilin pedagog. Njëherazi, ato janë një burim i rëndësishëm për të nxjerrë konkluzione mbi cilësinë e punës së secilit, në disa raste janë shoqëruar edhe me marrjen e masave konkrete ndaj pedagogëve të ndryshëm. Ndër problemet më kryesore kanë qënë lidhur me literaturën e rekomanduar, shfrytëzimin e orës së mësimi, cilësinë në shpjegim dhe kontrollin e dijeve, etj. Një formë tjetër e sigurimit të cilësisë është dhe kontrolli i provimeve të ndërmjeteme dhe atyre të semestrit. Katër herë në vit KSBC kryen këtë proces, rezultatet e të cilit pasqyrohen në raportet përkatëse.

Duke filluar nga viti akademik 2016-2017 UET ka vënë në përdorim platformën LMS (Learning Management System) për menaxhimin e mësimdhënies online. LMS është një aplikacion web për administrimin, dokumentimin, ndjekjen, raportimin dhe shpërndarjen e materialeve mësimore dhe informacionit tjetër të rëndësishëm për studentët. Ky sistem ofron informacion të personalizuar për çdo përdorues të student apo pedagog. Çdo student, apo pedagog që hyn në sistem, merr vetëm informacionin që i përket atij. Funkzioni kryesor i këtij sistemi është të lehtësojë komunikimin dhe shkëmbimin e materialeve të studimit dhe informacionit (njoftimet detyrat që duhen dorëzuar, afatet e dorëzimit, etj.) mes pedagogut dhe studentëve, duke ndihmuar në rritjen e cilësisë së mësimdhënies, pasi studenti merr përmes sistemit, gjithë bazën didaktike dhe orientimet e pedagogut për lëndën, si edhe ka mundësi t'i drejtojë atij pyetje për paqartësitë e mundshme. Njëkohësisht, ai është edhe një mjet eficient në dispozicion të KSBC-së për të monitoruar mbarëvajtjen e procesit të akademik, përmes të dhënave statistikore të gjeneruara nga ky sistem.

Nga ana tjetër në takimin me studentët në morëm komente pozitive të tyre që konfirmojnë të njëjtën gjë, më konkretisht: Stafi akademik shumë i mirë e i kualifikuar, komunikim i afërt me pedagogët, metoda dhe të knologji të mira të mësimdhënies, ndihma personale si konsultimet sa herë që studentët dëshirojnë nga stafi akademik, etj

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:



Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:

Gjatë vitit akademik realizohen 2 anketime me studentët dhe konkretisht në përfundim të procesit mësimor të çdo semestri. Gjatë viteve të fundit anketimet janë bërë online ku rreth 65 % e studentëve kanë plotësuar anketën. Të gjitha anketat janë përpunuar dhe rezultatet e tyre janë prezantuar në Departamentin e Financës dhe Ekonomiksit nga Përgjegjësi i Departamentit.

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:

Të tërthorta:



- Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve,
- Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit;
- Pyetje konceptuale;
- Intervista;

Të drejtpërdrejta:

- Teste të standardizuara
- Dëgjime në auditor;
- Vlerësimi me pikë;
- Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë;
- Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

KSBC-ja si strukturë direkte e menaxhimit të cilësisë ka përgjegjësinë kryesore për monitorimin e saj. Në kuadër të kësaj përgjegjësie kjo njësi realizon analiza vjetore të ecurisë së programeve të nivelit MP në Financë dhe problematikën e dalë . Në funksion të kësaj problematike instancat drejtuese në qënder dhe ajo e njësisë bazë mësimore shkencore; parashetrojnë masat që duhen ndërmarrë për përmirësimin e procesit dhe rritjen e cilësisë.

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Institucioni analizon mbi bazë fakulteti dhe departamenti ecurinë e rezultateve lidhur me cilësinë e mësimdhënies nga gjithë metodat e brendshme që përdor institucioni si dhe duke përfshirë në to mendimin e përfaqësuesve të tregut të punës dhe opinionin e studentëve.

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Mbështetur në mendimin e personelit akademik, të anëtarëve të Bordit të Tregut të Punës (ngritur në nivel Departamenti) dhe opinionit të shfaqur nga studentët, kryesisht të atyre të organizuar në “fokus grupe” dhe pyetësorët online, institucioni programon politika dhe ndërmerr masa për zhvillimin e mëtejshëm të programeve të studimit, për të reflektuar në to zhvillimet bashkëkohore me karakter teorik si dhe kërkesat e tregut të punës lidhur me aspektin praktik.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi L.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;	KSBC, është struktura përgjegjëse për menaxhimin e vlerësimit për ecurinë e programeve të studimit Për secilin nga proceset akademike që kontrollohen gjatë vitit akademik dhe rezultatet e tyre ajo raporton pranë rektoratit dhe dekanateve të fakulteteve. Vlerësimin e cilësisë së programit e prezanton nëpërmjet raporteve periodike pranë instancave vendimarrëse përkatëse më të larta si dhe pranë Departamentit.
Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;	
Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;	

<p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve; Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; Etj. <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj); Dëgjime në auditor; Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë; Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale; Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatat, projektet, provimet, etj.); Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës; Etj. 	<p>UET kryen në mënyrë të rregullt vlerësimin e veprimtarisë akademike dhe administrative përmes metodash të tërthorta, kryesisht në formën e sondazheve me të gjithë studentët, për të gjitha lëndët dhe të gjithë pedagogët. Rezultatet e tyre i vë në dispozicion të drejtuesve të institucionit, atyre të fakulteteve si dhe reflektohen në vlerësimin e performancës së çdo pedagogu në përfundim të vitit akademik. Kujdes i kushtohet intervistave me studentët, si edhe ato me pedagogët gjatë shqyrtimit të performancës së tyre.</p> <p>Në mënyrë sistematike nga ana e sektorit të statistikave përpunohen të dhënat mbi rezultatet e studentëve në studimet e tyre në UET, kalueshmëria për lëndë dhe pedagog, etj.</p> <p>Për kryerjen e vlerësimit, përdoren metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:</p> <p><u>Të tërthorta:</u> Sondazhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve, Sondazhe vlerësimi të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, pyetje konceptuale, intervista</p> <p><u>Të drejtpërdrejta:</u> Teste të standardizuara, Dëgjime në auditor, Vlerësimi me pikë; Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë; Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët, Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës</p>
<p>Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>UET përgatit dhe shpërndan në formën e një raporti vlerësimet periodike mbi cilësinë, i cili u vihet në dispozicion strukturave drejtuese por edhe pedagogëve, sikurse dhe aktorëve të tjerë të interesuar.</p> <p>Këto raporte janë pjesë e diskutimit/ prezantimit në nivel rektorati sikurse dhe në nivel departamenti.</p>
<p>Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Bazuar në vlerësimin me pikë të procesit të mësimdhënies për çdo personel akademik mësimdhënes KSBC-ja përfshin në analizen vjetore të ecurisë së programeve të nivelit Master problematiken e dalë. Në funksion të kësaj problematike instancat drejtuese në qendër dhe ajo e njësisë bazë mësimore shkencore; Departamenti</p>

	<p>parashtrojne masat që duhen ndërrmarrë për përmirësimin e procesit dhe rritjen e cilësisë. Institucioni analizon mbi bazë fakulteti dhe departamenti ecurinë e programeve të studimeve, duke përfshirë në to mendimin e përfaqësuesve të tregut të punës dhe opinionin e studentëve.</p> <p>Mbështetur në mendimin e personelit akademik, të anëtarëve të Bordit të Tregut të Punës (ngritur në nivel Departamenti) dhe opinionit të shfaqur nga studentët, kryesisht të atyre të organizuar në “fokus grupe” dhe pyetësorët online, institucioni programon politika dhe ndërmerr masa për zhvillimin e mëtejshëm të programeve të studimit, për të reflektuar në to zhvillimet bashkëkohore me karakter teorik si dhe kërkesat e tregut të punës lidhur me aspektin praktik.</p>
<p>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>Në kuadër të plotësimit të standardeve institucionale UET-i është akredituar dhe riakredituar, bazuar në legjislacionin në fuqi. Programet e studimit për të cilat ka nisur procesi i akreditimit periodik, janë akredituar nga institucionet përgjegjëse.</p> <p>Sigurimi i cilësisë realizohet përmes përfshirjes së personelit akademik dhe atij ndihmës, ushtrimit të kontrollit nga ana e strukturave drejtuese dhe KSBC, tërheqjes së mendimit të studentëve, të antarëve të Bordeve të Tregut të Punës si edhe bashkëpunimit me ASCAL-in dhe struktura të tjera shtetërore. Kujdes i kushtohet zbatimit me rigorozitet të legjislacionit në fushën e arsimit, me fokusim të veçantë në standardet e cilësisë për të gjitha nivelet.</p> <p>Për të siguruar cilësinë e proceseve akademike UET harton politikat përkatëse përmes shqyrtimit dhe miratimit të tyre në Senatin Akademik dhe strukturat e tjera në nivel njësie kryesore dhe njësie bazë.</p> <p>Një rol të veçantë luajnë mekanizma si grupet e punës për probleme të veçanta, ndër të cilët përmendim atë për format e kontrollit; organizimi i pyetësorëve me studentët aktualë dhe ata që janë diplomuar në UET, sistemin LMS, etj.</p> <p>Ndërgjegjësimi i personelit synohet përmes një larmie formash, nga trajnimi deri te rifreskimi i njohurive mbi standardet dhe kërkesat e veçanta për cilësi. Po ashtu, studentët njihen me kërkesat mbi cilësinë në UET me fillimin e vitit akademik</p>

	<p>dhe gjatë vitit në takime të veçanta me drejtuesit e institucionit, pedagogët, etj.</p> <p>Strategjia mbi sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë zbatohet përmes veprimtarisë së strukturave drejtuese, aktivitetit të KSBC dhe reflektohet në format dhe formatet standarde të publikura në intranetin e UET.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>UET nëpërmjet KBSC ,vlerëson periodikisht treguesit e veprimtarive mësimore, kërkimore dhe administrative të Institucionit, duke përdorur metoda direkte dhe indirekte të vlerësimit. Bazuar në shqyrtimet e detajuara dhe verifikimeve në institucion, konstatohet se UET-ja nëpërmjet KBSC –së dhe organeve të tjera vendimmarrëse, duke filluar nga Departamenti i Financës dhe Ekonomiksit dhe deri te Senati i Universitetit, kanë përdorur instrumentët e duhura për sigurimin e cilësisë, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herë pas herë të programeve përfshirë edhe MP në Financë me profile.</p> <p>Sa me sipër GVJ konkludon se Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë pranë UET-së i plotëson plotësisht standardet e kërkuara.</p>	

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Programi i studimit MP në Financë me profile, ofrohet nga Departamenti i Financës dhe Ekonomiksit i cili është pjesë përbërëse e Fakultetit të Ekonomisë dhe Teknologjisë së Informacionit.

Misioni i Programit MP në Financë me profile është përgatitja e studentëve me njohuritë teorike, profesionale dhe shkencore në fushën e financave, bankave, sigurimeve, kontabilitetit dhe raportimit financiar, auditit dhe politikës fiskale. Në funksion të këtij misioni, objektivi kryesor i këtij programi është të pajisë studentët me njohuri të plota në fushën e financës dhe nenfushëve të saj sipas profileve të përcaktuara në program. Duke njohur tregun e punës në këto fusha të diplomuarit e këtij programi kanë mundësi të mëdha për punësim në institucionet financiare private dhe publike si, kontabilist apo financiere të siper marrjeve, auditore të tyre deri specialiste të sistemit fiskal shqiptar. Në zhvillimin e programit ofrohen teknikat bashkekohore të mësimdhënies, si laboratorë kompjuteri, lidhje intërnëti dhe një bibliotekë që ofron literaturën e kesaj fushe.

Objektiva të tjera të programit MP në Financë konsistojnë edhe në :




- Përfitimim të aftësive praktike për të kuptuar problemet e riskut në sektorin bankar, te sigurimeve, auditin etj.
- Përfitimim e njohurive teorike dhe shkencore lidhur me financat dhe bankat, tregjet e tyre dhe analizës se performancës dhe veprimtarisë bankare.
- Aftësimin e studentëve në përdorimin e programeve kompjutrike në përdorimin zyrtar të përditshëm dhe për vlerësimin e të dhënave statistikore në departamentët e bankave sipermarrjeve, institucionet fiskale etj.

Një drejtim tjetër i objektivit të këtij programi është të kompletojë studentet me njohuri të plota në një profil të ngushtë si pjesë e financave me mundësi aplikimi në segmente të tregut financiar. Ky program për të gjitha profilet përfshin gjithsej 6 lëndë, praktiken profesionale dhe punimin e diplomës. Nga këto 6 lëndë 1 prej tyre domethënë 10 % është e karakterit të përgjithshëm (Kategoria A), 3 prej tyre domethënë 30 % janë disiplina të formimit karakterizues (Kategoria B), 2 lëndë në disiplina të ngjashme dhe/ose integruese domethënë 20 % (kategoria C), 16.7% praktika (Kategoria E) dhe 23.3% punimi i diplomës (Kategoria F). Frekuentimi i procesit mësimor (leksione, seminare, etj) është i detyrueshëm në masën 80%. Literatura në funksion të përgatitjes së një punimi diplome apo të përgatitjes në tërësi për një diplomim cilësor dhe në funksion të objektivave që përcakton programi i studimit, përgjithësisht ka qenë e zgjedhur mirë, por në disa raste është e përgjithshme, vetëm në një gjuhë të huaj dhe jo në dy a më shumë gjuhë. Kontrolli akademik i njohurive është realizuar korrekt dhe nëpërgjithësi janë respektuar format e kontrollit të njohurive të përcaktuara në silabusin e lëndëve si edhe me shënimet përkatëse rreth përgjigjeve të pyetjeve me zhvillim. Literatura e ofruar për studentët është e viteve të fundit e mbështetur në literaturën bashkohore. Krahas literaturës së detyruar studentëve u jepet dhe literaturë e rekomanduar për të pasuruar njohuritë. Ky program e përgatit studentin me aftësitë dhe kompetencat profesionale për të dalë në tregun e punës.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Ky program është riorganizuar me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr 233 datë 06.06.2013 si Master Profesional (MP) në Financë me 5 profile; *Banka; Sigurime; Kontabilitet dhe Raportim Financiar; Qeverisje dhe Auditim dhe Politika Fiskale* ne variantet me 60 ECTS dhe 90 ECTS, që kishin një periudhe përkatësisht 1 vit kalendarik dhe 1.5 vite kalendarike. Duke filluar nga viti akademik 2016-2017 dhe në vazhdim programi ofrohet vetëm në variantin me 60 kredite.

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

- Programi MP në Finance zgjat 1 vit akademik me 2 semestra që ka 28 javë mësimore në auditor, përfshirë edhe javën e provimeve.
- Një semestër ka 14 javë mësimore në auditor, përfshirë edhe javën e provimeve.
- Një orë mësimore = 60 minuta.
- Studenti realizon çdo vit jo më pak se 1500 orë punë.
- Një vit akademik ka 60 ECTS.

Bazuar ne fokusin e zhvillimit te 6 lëndëve qe perfshihen ne program 1 prej tyre domethënë 10 % është e karakterit të përgjithshëm (Kategoria A), 3 prej tyre domethënë 30 % janë disiplina të formimit karakterizues (Kategoria B), 2 lëndë në disiplina të ngjashme dhe/ose integruese domethënë 20 % (kategoria C), 16.7% praktika (Kategoria E) dhe 23.3% punimi i diplomës (Kategoria F). Frekuentimi i procesit mësimor (leksione, seminare, etj) është i detyrueshëm në masën 80 (tetëdhjetë) për qind.

Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë

33

Referuar RVB plani mësimor i detajuar sipas numrit të lendeve për semestër është paraqitur në (Tabela 7Aneks)

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit

Referuar RVB dhe takimeve në institucion, treguesit e llogaritjes së krediteve janë :

Një ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit qe perfshin:

- Leksionet 11 orë në auditor dhe 14 orë punë e pavarur e studentit
- Seminaret 7 orë në auditor dhe 18 orë punë e pavarur e studentit
- Projekt/detyra/ushtime 12 orë në auditor dhe 13 orë punë e pavarur e studentit
- Praktikën Profesionale 22 orë në auditor dhe 3 orë punë e pavarur e studentit
- Punim diploma 1.5 orë në auditor dhe 23.5 orë punë e pavarur e studentit

Nga programi ne nxjerrim dhe treguesit total për cdo profil si më poshtë.

- Për leksionet 168 orë në auditor dhe 207 orë punë e pavarur e studentit
- Për Seminaret 84 orë në auditor dhe 216 orë punë e pavarur e studentit
- Ushtime 108 orë në auditor dhe 117 orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikën Profesionale 220 orë në auditor dhe 30 orë punë e pavarur e studentit
- Provimi përfundimtar 20 orë në auditor dhe 330 orë punë e pavarur e studentit

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara

Në krahasim me programin mësimor të licensuar janë bërë zëvendësime në dy lëndë. Përkatësisht janë zëvendësuar lënda "Menaxhim Financiar" me lëndën e disiplinës së përgjithshme "Medodat e kerkimit të avancuar", si dhe lënda "Analize financiare e avancuar" e disiplinave të formimit tek profili "Banka" me lëndën "Audit bankar". Këto ndryshime janë mundësia maksimale për ndryshim në këtë duke zene nje peshe specifike prej afro 17 % nga 20 % qe eshte mundesia maksimale e ndryshimit.

(Tabela 8 në Aneks).

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës

Ashtu sic e kemi trajtuar më sipër, në zhvillimin e programit PAE kundrejt PAK gjatë 3 viteve të fundit ka mbuluar rreth 80 % të këtij programi me një prirje në rritje. (Tabelat 10-1, 10-2, dhe 10-3 në Aneks)

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

Nga shqyrtimi i syllabusve vërejmë se ato përmbajnë elementet e mëposhtëm:

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studentit për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik

- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Gjatë vizitës pranë institucionit ne vlerësuam cilësinë e syllabuseve të programit dhe njëkohësisht krahasuam ato me syllabuset e prezantuara në dosjen e Vetvlerësimit të institucionit. Hartimi i syllabuseve të programit përfshinte të gjitha elementet e nevojshem duke plotësuar kriteret për to.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Programi MP ne Financë me profile që ofrohet në UET është akredituar me Urdhër të Ministrit Arsimit dhe Shkencës Nr. 68, datë 14.02.2011.</p> <p>Programi është i organizuar në përputhje me udhëzimet e MAS dhe lëndët e modulet vlerësohen me kredite ECTS.</p> <p>Duke shqyrtuar planin mësimor vëmë re që në te janë përcaktuar një numër i njëjtë kreditesh për të gjitha lëndët që është 6 ECTS. Bazuar në metodologjine e përcaktimit të krediteve si dhe në mjaft eksperiencën të programeve në universitete të tjera numri i krediteve mund të jetë i ndryshëm për lëndë të ndryshme.</p> <p>Kjo rrjedhë e vështirëise apo orëve të angazhimit jashtë auditorit që për lëndë të veçanta mund të jenë më shumë se për disa lëndë të tjera. Ky “uniformitet “ në përcaktimin e krediteve për të gjitha lëndët e programit barazon notën mesatare të llogaritur si mesatare e thjeshtë me notën mesatare të llogaritur si mesataren e ponderuar me kreditet.</p> <p>Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë programit MP ne Finance nga një student që ndjek kete program studimi me kohë të plotë është 60 kredite.</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p>	<p>Programi MP në Financë me profile, i pajis studentët që zotërojnë një diplomë në Bachelor, me njohuri më të thelluara teorike dhe praktike të fushës së financës duke u dhënë më shumë mundësi në tregun e punës.</p>

<p>Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p>Kriteri 7 Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionalë, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Programi bazohet mbi njohuritë e marra në ciklin e parë të studimit. Nga shqyrtimi i syllabusve vihet re që ka një trajtim të shpejte të koncepteve në financë që janë marrë në programin bachelor. Ky trajtim është i domosdoshëm në kushtet kur në këtë program kanë mundësinë që ta ndjekin edhe student që nuk kanë mbaruar studimet e ciklit të parë në fushën e financës apo ekonomisë.</p> <p>Programi arrin të pajisë studentët me kompetenca të përgjithshme në fushën e financës dhe profilit përkatës. Programi synon që të rrisë edhe kompetencat profesionale të studentëve me fokus rritjen e aftësive praktike në profilet e tij që përfshijnë fushën e bankave, sigurimet, kontabilitetin, auditin apo problematikat fiskale.</p> <p>Mbështetur në 6 lëndet që ofron programi në secilën prej profileve të tij por edhe në praktikën profesionale të përfshirë në të, programi arrin të ketë objektiv rritjen profesionale të studentëve. Në këtë kuadër praktika profesionale dhe përgatitja e diplomës që synohet të jetë aplikative i shërbejnë këtij objektiv.</p>
<p>Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p>Kriteri 2 Metodot e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Programi në përmbajtjen e tij ofron tiparet e një programi të nivelit të dytë në fushën e financës. Programi ndërtohet mbi njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimit, dhe thellon njohuritë dhe aftësitë e studentëve në përputhje me kriteret e vendosura.</p> <p>Nga verifikimi që bëhet gjatë vizitës në institucion rezultojnë kontroll periodik i njohurive të marra me anë të testeve apo provimit përfundimtar.</p>
<p>Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.</p>	

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikën e mira të vendeve europiane;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuara në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Programi në hartimin dhe zhvillimin e tij bazohet në eksperiencat bashkëkohore europiane dhe të vendit, si edhe duke vlerësuar nevojat e tregut të punës.</p> <p>Mbështetur në lëndët që përfshihen në të, programi arrin të trajtojë elementët e nevojshëm që lehtësojnë njohjen dhe ekuivalentimin e diplomës jashtë vendit, për qëllim vazhdimin e studimeve apo punësimit e studentit.</p> <p>Programi i studimit është në përputhje me objektivat e përcaktuara në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>
Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>Ashtu siç kemi theksuar më lart, programi synon aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor. Në kushtet kur ky program realizohet brenda një viti kalendarik ,përfshin trajtimin e 6 lëndëve dhe në total ofron 60 ECTS, aftësimi profesional duhet të zërë më shumë vend në të. Mbështetur edhe nga interesat e studentëve që preferojnë të regjistrohen në këtë program që konsiston në rritjen e aftësimin profesional, <i>mendojme se programi në lëndët që ofron apo trajton duhet të ketë me shume trajtime praktike.</i></p> <p>Sa më sipër, për ti dhënë përparësi trajtimit profesional mendojmë që lenda “Metoda kerkimi te avancuar” nuk i pergjigjet nivelit të këtij programi. Dihet që të trajtosh këtë lëndë duhet një bazë e fuqishme teorike dhe zotërimi i disa lëndëve që janë karakteristikë e trajtimit në Master Shkencor (te tilla si “<i>Ekonometri</i>”, “<i>Statistike biznesi</i>” etj)</p> <p>Mbështetur në temat që trajtohen në çdo lëndë të shprehura në syllabuset konceptet dhe trajtimet teoriko shkencore zënë vend në një pjesë të konsiderueshme në to.</p> <p>Gjithashtu, në kushtet kur gjithë programi zhvillon 6 lëndë dhe ndryshimin e profileve e bëjnë vetëm 2 lëndë <i>rekomandojmë zëvendësimin e kësaj lënde apo “ Hyrje ne Ekonometri” me një lende tjeter te profesionit të profilit përkatës.</i></p> <p>Aftësimi shkencor i studenteve do të arrihej më mirë edhe gjatë përgatitjes së punimit të diplomes ku konsultimi dhe ndihma e udhëheqësve të diplomës do të kontribonin në përgatitjen e një punimi sa aplikativ aq edhe shkencor.</p> <p>Programi i studimit është në përputhje me strategjinë e zhvillimit të UET-it. Ky program kërkon që në</p>

përputhje me strategjinë e zhvillimit të UET-së të arrijë të përthithë studentë që kanë interesa profesionale në tregun e punës si dhe ngritje teorike të nivelit të tyre.

Ne mendojmë që ende edhe për një periudhë 2-3 vjetecare ka një numër të konsiderueshëm studentësh potencial që do të preferonin kryerjen e një programi me jetgjatësi 1 vit kalendarik me përfitime kryesisht në tregun e punës dhe ngritjen teorike të tyre.

Nëse e shikojmë këtë zhvillim të ardhshëm në një periudhë kohore afatmesme të zhvillimeve në treg mendojmë se UET-së do ti duhet të zhvillojë program MP në financë me kohëzgjatje 2 vite (përfshirë periudhën e përgatitjes së punimit të mikrotezes që është 1 semester) dhe me 120 ECTS.

Mbeshtetur në vleresimet periodike që bën institucioni personeli akademik angazhohet në punën kërkimore jo vetëm në interes të ecjes përpara profesionalisht, por dhe për të përmbushur detyrimet sipas kontratës së nënshkruar me UET. Rritja e punës së tyre kërkimore shkencore i shërben edhe rritjes cilësore të mesimdhënis në këtë program.

Standardi I.7 - Programet e studimeve "Master Profesional" ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.

Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;

Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.

Programi Master Profesional me 5 profilet që UET ofron ka natyrë aplikative dhe ofron formim praktik, për arritjen e objektivave profesionale sipas profilit të zgjedhur, me qëllim punësimin ose kualifikimin në një drejtim të ngushtë.

Mbeshtetur në lëndët e ofruara në program vërejmë se një pjesë e konsiderueshme e tyre janë disiplina të formimit karakterizues (3 nga 6 gjithsej) dhe disiplina të ngjashme me to (2 lëndët e profilit).

Për të plotësuar sa më mirë këto kritere, mendojmë që lëndët e "trungut" të përbashkët (veprimtaria të formimit karakterizues B) që zhvillohen në të gjitha profilet nga 3 të bëhen 2 duke shtuar lëndët e profilit përkatës, që nga 2 mund të bëhen 3 (veprimtaria të ngjashme C).

Në përforcim të këtij rekomandimi është edhe fakti që lënda "Tregjet e kapitaleve dhe institucionet financiare" jo vetëm që është relativisht teorike, por ka mbivendosje me lëndën "Tregu bankar dhe Institucionet e tij". Ky rregullim do të përforconte me shumë objektivin kryesor që ka ky program që është përgatitja e specialisteve të aftë me njohuri aplikative.;

Nga shqyrtimi me vemendje i syllabusve vume re se për lëndë të njëjta që zhvillohen në këtë program dhe në

	<p>programin Msc në Financë Bankë përmbajtja në syllabus është e njëjtë.</p> <p>Në funksion edhe te objektivave te këtij programi ne syllabus mund te reflektoheshin ndryshimet krahasuar me zhvillimin e të njëjtës lëndë në programin Msc në Financë Bankë.</p>
<p>Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Numri relativisht i lartë i studenteve të regjistruar në këtë program gjatë gjithë viteve pas akreditimit të parë dhe aktualisht tregon se kjo kërkesë ka reflektuar kërkesat e tregut të punës në fushën e financës. Ky treg është zgjeruar edhe në segmente të tij sidomos po të kemi parasysh zhvillimet pozitive në tregun e sigurimit, kontabilitetit, auditimit dhe sektorit fiskal.</p> <p>Nga takimet që patëm në institucion vumë re se UET analizon vazhdimisht zhvillimet në tregun e punës, duke u fokusuar në mundësitë e punësimit të studentëve, indentifikimin e qartë të kërkesave të punëdhënësve në mënyrë ato të gjejnë përgjigje në zhvillimin e programit të studimit nga UET. Rekomandimet e Bordit të Tregut të Punës, ku bëjnë pjesë përfaqësues të kompanive më në zë të sektorit, pasqyrohen vazhdimisht në programet e lëndëve dhe në gamën e lëndëve me zgjedhje që ofrohen.</p> <p>Nga ana tjetër nje pjesë e studentëve që kanë ndjekur dhe ndjekin kete program janë të punësuar dhe kanë kërkesa për të bërë karrierë në këtë treg apo te specializohen më tej në segmente të tregut financiar.</p> <p>UET- parashikon qe edhe per 2-3 vitet e ardhshme numri i studenteve të regjistruar të ketë të njëjtën prirje të viteve të fundit.</p>
<p>Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi i studimit është në përputhje me këto dy kritere. Gjatë hartimit dhe rishikimit të programeve të studimit janë mbajtur parasysh objektivat kombëtare të zhvillimit. Në qendër është formimi i studentëve që të jenë të aftë për punë në shërbim të shoqërisë.</p>
<p>Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</p>	
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve “Master Profesional” realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.</p>	<p>Nga viti akademik 2016-2017, programi ofrohet me 60 kredite. Kohëzgjatja normale e programit është 1 vit akademik. Punimi i diplomës realizohet me 14 ECTS.</p> <p>Më parë programi është ofruar me 60/ 90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tij ka qenë 1.5 vite, në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.</p>

<p>Kriteri 3 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës “Master i Shkencave”. Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).</p>	N/A
<p>Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;</p> <p>Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	<p>Programi i studimit, me lëndët përbërëse të tij, sipas viteve dhe semestrave është i publikuar në faqen e internetit të UET-it.</p> <p>Gjithashtu, studentët në fillim të secilit semestër pajisen me të gjithë syllabuset e lëndëve, ku jepen në detaje temat e lëndës, literatura kryesore, forma e kontrollit të dijeve, literatura e rekomanduar.</p> <p>Ky informacion tashmë është edhe pjesë e platformës LMS, ku çdo student sheh gjithë materialet e lëndës që pedagogët vendosin në portal, krahas syllabusit.</p>
<p>Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.</p>	
<p>Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;</p> <p>Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion ne verifikuam dhe konfirmuam që UET ka dokument të shkruar që shpjegon dhe instruktore studentët për procedure dhe mënyrën e përgatitjes së punimit të diplomës edhe për nivelin e dytë të programeve ku përfshihet edhe MP në Finance. Ky dokument u behet i qartë studentëve dhe gjatë periudhës së përgatitjes së punimit të diplomes udhëheqesi mbikqyre edhe zbatimin rregullave të percaktuara në këtë dokument.</p> <p>Bazuar në programin mësimor për realizimin e programeve të studimeve “Master Profesional” janë parashikuar 14 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <p>Departamenti i Financës dhe Ekonomiksit i UET-së ofron programin e studimit MP në Financë me 5 profile i cili ofrohet që nga viti akademik 2011-2012, në variantin 60 ECTS dhe 90 ECTS dhe që nga viti akademik 2016-2017 e në vazhdim vetëm në variantin me 60 ECTS. Studimet në këtë program organizohen në module dhe vlerësohen në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe të Grumbullimit të Kreditëve (ECTS).</p> <p>UET-ja dhe Departamenti i Financës dhe Ekonomiksit si njësi kryesore ku Programi MP në Financë-Banke me 5 profile zhvillohet ofron informacionin e plotë të këtij programi për të interesuarit nëpërmjet faqes së internetit ku përfshihen; lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër, ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ndjekjen e programit, syllabuset e detajuara për secilën lëndë, etj.</p> <p>Bazuar në RVB, takimet e realizuara gjatë vizitës në institucion, dhe dokumenteve të kërkuara dhe marrë nga institucioni konkludojmë se programi i studimit MP në Finance me 5 profilet është në përputhje me objektivat, strategjinë e UET, si dhe kërkesat e legjislatimit në fuqi dhe i plotëson kryesisht standardet e programit të studimit dhe organizimit të tij.</p>	

Rekomandojmë

- Në kushtet kur ky program realizohet brenda një viti kalendarik, përfshin trajtimin e 6 lëndëve dhe në total ofron 60 ECTS aftësimi profesional duhet të zërë më shumë vend në të. Mbeshtetur edhe nga interesat e studenteve që preferojnë të regjistrohen në këtë program që konsiston në rritjen e aftësisë profesionale, mendojmë se programi në lëndët që ofron apo trajton duhet të ketë me shume trajtime praktike. Sa me siper, për ti dhene perparesi trajtimit profesional mendojme qe lenda “Metoda kerkimi te avancuar” nuk i pergjigjet nivelit te ketij program. Dihet qe te trajtosh kete lende duhet nje baze e fuqishme teorike dhe zoterimi i disa lendeve që janë karakteristik e trajtimit në Master Shkencor (të tilla si “Ekonometri”, “Statistike biznesi” etj) Mbeshtetur ne temat që trajtohen ne çdo lende te shprehura ne syllabuset konceptet dhe trajtimet teoriko shkencore zene vend në nje pjese te konsiderueshme ne to. Gjithashtu, në kushtet kur gjithë programi zhvillon 6 lende dhe ndryshimin e profileve e bejne vetem dy lende rekomandojme zevendesimin e kesaj lende apo “ Hyrje ne Ekonometri” me nje lende tjeter te profesionit te profilit perkates.
- Programet Master Profesional me 5 profilet qe ai ofron kanë natyrë aplikative dhe ofrojnë formim praktik, për arritjen e objektivave profesionale sipas profilit të zgjedhur, me qëllim punësimin ose kualifikimin në një drejtim të ngushtë. Mbeshtetur në lendet e ofruara në program vërejmë se nje pjese e konsiderueshme e tyre jane disiplina te formimit karakterizues (3 nga 6 gjithsej) dhe disiplina te ngjashme me to (2 lendet e profilit). Per te plotesuar sa me mire keto kritere, mendojme qe lendet e “trungu” te perbashket (veprimtaria te formimit karakterizues B) që zhvillohen ne te gjitha profilet nga 3 te behen 2 duke shtuar lendet e profilit perkates që nga 2 mund te behen 3 ((veprimtaria te ngjashme C). Ne perforcim te ketij rekomandimi eshte edhe fakti qe lenda “Tregjet e kapitaleve dhe institucionet financiare” jo vetem qe eshte relativisht teorike, por ka mbivendosje me lenden “Tregu banker dhe Institucionet e tij”. Ky rregullim do te perforconte me shume objektivin kryesor qe ka ky program qe eshte pergatitja e specialisteve te afte me njohuri aplikative.
- Duke shqyrtuar planin mesimor veme re që në të janë percaktuar numer i njejte kreditesh per te gjitha lendet qe eshte 6 ECTS. Bazuar ne metodologjine e percaktimit te krediteve si dhe ne mjaft eksperiencia te programeve ne universitete te tjera numri i krediteve mund te jete i ndryshem per lende te ndryshme. Kjo rrjedhoje e veshtiresise apo oreve te angazhimit qe per lende te veçanta mund te jene me shume se per disa lende te tjera. Ky “uniformitet “ ne percaktimin e krediteve per te gjitha lendet e programit barazon noten mesatare te llogaritur si mesatare e thejshte me noten mesatare te llogaritur si mesataren e ponderuar me kreditet.
- Vendimet e mepareshme te miratimit te programit MP ne Finance me te 5 profilet dhe akreditimit te pare te tij percaktojne te dy periudhat e mundshme te zgjatjes se ketij program me 60 kredite dhe 1 vit akademik dhe 90 kredite me periudhe zhvillimi 1,5 vjet. Ndofta kjo mosperputhje duhet saktësuar ne vendimin per riakreditim.
- Nga shqyrtimi me vemendje i syllabusve vume re se per lende te njehta qe zhvillohen ne kete program dhe ne programin Msc ne Financë Bankë permbajtja ne syllabus eshte e njejte. Në funksion edhe te objektivave te ketij programi në syllabus mund të reflektoheshin ndryshimet krahasuar me zhvillimin e te njejtës lende ne programin Msc në Financë Bankë.

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Mësimdhënia në programin MP në Financë me profile bazohet në Rregulloren e Studimeve Universitare dhe Provimeve e cila përcakton format e mësimdhënies dhe vlerësimin e dijeve të studentëve. Procesi mësimor zhvillohet nepermjet formave të mirënjohura; leksione, seminare, leksion/seminare, detyra kursi, provime të ndërmjetme, provime përfundimtare, praktika profesionale dhe punim diplome. Në kete program lëndët zhvillohen në grupe leksion/seminari (3 orë/javë) me rreth 50–60 studentë. Provimet përgjithësisht janë mbajtur në formë të shkruar. Megjithatë, pedagogu i lëndës ne kuader te irise akademike mund të vendosë për të kryer provimin në formën e një provimi me gojë, projekt ose detyrë kursi.

Për koordinimin e vazhdueshëm të punës së personelit akademik, në përputhje me planet strategjike, veprimtaritë dhe procedurat e miratuara, Departamenti i Financës dhe ekonomiksit organizon mbledhje të zakonshme çdo javë.

Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies së personelit akademik kryhet përmes:

- praktikës së leksioneve të hapura, e cila zhvillohet në një nga temat e planifikuara, me pjesëmarrjen e kolegëve të interesuar; Nga takimi me drejtuesin e Departamentit te Finances dhe Ekonomiksit ne konfirmuam kete.
- vlerësimin të studentëve që kryhet në fund të semestrit, i cili ruan anonimatit e tyre;
- vlerësimin të Dekanit dhe/ose Përgjegjësit të Departamentit përkatës/ose grupit *ad hoc*, i ngritur me urdhër të Rektorit, në raste të veçanta të evidentimit të nevojës për përmirësimin e cilësisë;
- vlerësimin nga Komisioni i Vlerësimin të Performancës që ngrihet nga Rektori, në fund të çdo viti akademik (folloë-up).

Rezultatet e përpunuara u bëhen me dije personelit akademik të interesuar dhe autoriteteve drejtuese Sekretaria Mësimore mban evidencat për zhvillimin e orëve të mësimin, leksione/seminare. Ajo raporton në fund të çdo jave, për orët e pazhvilluara te Sekretari i Përgjithshëm, te Dekanët e Fakulteteve dhe te Zyra e Burimeve Njerëzore. Dekani dhe Përgjegjësi i Departamentit në bashkëpunim me Sekretarinë Mësimore monitorojnë zhvillimin e procesit mësimor në përputhje me orarin i cili ishte i shpallur.

Sa i takon cilësisë së mësimdhënies, shohim përmbushje te standardeve të brendshme në lidhje me cilësinë e organizimit të lëndëve, përzgjedhjes së literaturës (në gjuhë të huaj dhe shqipe), si dhe mjeteve e metodave të larmishme didaktike të përdorura gjatë leksioneve dhe seminareve. Cilësia e mësimdhënies lidhet ngushtë me fushën e ekspertizës apo interesave kërkimore shkencore të pedagogëve, të cilat janë pasqyruar në artikuj e botime të tjera shkencore, workshope dhe konferenca. Ndërkohë studentët janë shprehur pozitivisht për cilësinë e mësimdhënies dhe marrëdhëniet akademike me pedagogët e angazhuar për zhvillimin e lëndëve të programit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet janë (Tabela 11 në Aneks):

• Leksione	168 orë
• Seminare	84 orë
• Ushtrime	108 orë
• Praktikë profesionale	220 orë
• Punimi i diplomes	20 orë

Format e kontrollit të njohurive (Tabela 12 në Aneks)

- Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive. Specifikuar në syllabuset përkatëse
- Plotësimi i detyrimeve (detyrave tëkursit),Specifikuar në syllabuset përkatëse
- Testimet gjatë vitit, Specifikuar në syllabuset përkatëse
- Provimi përfundimtar, Specifikuar në syllabuset përkatëse
- Etj; të specifikuar në syllabus

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Në verifikuam qe studentët e programit MP në Financë kanë marrë pjesë në evenimente të organizuara nga Departamenti i Financës dhe Ekonomiksit. Aktivitete të tilla kanë përfshirë seminare, konkurse, samite apo forume të organizuara nga UET-ja. Disa të dhëna paraqiten më poshtë: **(Tabela 13 në Aneks)**

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Pranimi i studentëve në programin MP në Financë që ofrohet nga UET bazohet në kuadrin ligjor dhe rregullativ në fuqi si dhe në kriteret dhe procedurat e përcaktuara nga institucioni. Gjatë vizitës në institucion ne verifikuam me zgjedhje procesin e regjistrimit të studentëve në këtë program duke parë përmbajtjen e dosjeve të studenteve të regjistruar. Në dosjen e regjistrimit gjendeshin dokumentet e plotësuara të mëposhtme:

- Formulari i interesimit
- Kopje e noterizuar e diplomës të ciklit të parë që studenti ka fituar;
- CV-në e kandidatit, ku paraqiten të dhëna biografike dhe të eksperiencave profesionale.
- Një Letër Interesi (afërsisht 500 fjalë) ku paraqiten objektivat profesionale, interesat kërkimore dhe nxitjet për të kryer studimet e ciklit të dytë.
- Një projekt-ide ku paraqiten interesat e tij shkencore gjatë programit.
- Dy Letra Rekomandimi të cilat garantojnë kompetencën profesionale, përgatitjen akademike dhe mundësinë e kandidatit për të kryer studimet në këtë nivel.
- Paraqitja e një dokumenti që tregon aftësitë e kandidatit në njohjen e një gjuhe të huaj përbën avantazh.

Të gjitha dokumentet e mësipërme dorëzohen në Zyrën e Kontratave. Pas vlerësimit formal të listës së dokumenteve të nevojshme, dokumentacioni i kalon Departamentit përkatës i cili bën vlerësimin e aplikimeve dhe harton listën e kandidatëve të përzgjedhur. Çdo kandidat i përzgjedhur zhvillon një intervistë në Komitetin Shkencor të programit rreth projektit të zhvillimit të karrierës, në përputhje me fushën e studimit. Sekretaria mësimore e UET-se disponon statistika të detajuara vjetore për numrin e të diplomuarve për çdo program dhe cikël studimi në bazëviti akademik.

UET ofron lloje të ndryshme bursash të pjeseshme dhe të plota, ku për studentet e MP në Finance gjatë dy viteve akademik 2015-2016 dhe 2016 -2017 janë akorduar respektivisht 38 bursa dhe 15 bursa. Shqyrtimi dhe miratimi i bursave të pjeseshme dhe të plota të studimit, kryhet nga Komisioni i Akordimit të Bursave.

Bazuar në praktiken e universiteteve të huaja prej afro 2 vitesh pranë UET është formuar dhe operon Shoqata Alumni e cila në funksion të misionit të saj të vlerësimit dhe përmirësimit të cilësisë së shërbimeve, në mënyrë periodike mban kontakte të vazhdueshme me ish-studentët të cilët kanë kryer një cikël studimesh pranë UET. Kjo i shërben lidhjeve të UET me tregun e punës.

Një rol në nxitjen e punësimit të studenteve që perfundojnë programin MP në Finance ka dhënë program +250. Nëpërmjet këtij programi u sigurohet studentëve dhe Shoqatës ALUMNI një sërë mundësish për të mësuar dhe për të ndërvepruar me punëdhënës duke siguruar kontakte me industrinë dhe organizatat të ndryshme nëpërmjet programit 250+ kompanitë, kontratave të bashkëpunimit, Panairit të Punës, Leksionet e Hapura, kurseve dhe

internshipeve me kredite. Veçori e studenteve të regjistruar në programin MP në Finance me profile është fakti se një pjesë e konsiderueshme e tyre janë në marrëdhënie punësimi.

Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore në regjistra u konstatuan studentë pa numra matricullimi, kryesekretarja e argumentoi këtë fakt si vonesa të AKP konkretisht:

Për vitin 2015-2016 rezultoni në numër matricullimi 26 studentë
Për vitin 2016-2017 rezultoni në numër matricullimi 27 studentë
Për vitin 2017-2018 rezultoni në numër matricullimi të gjithë studentët

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

Procedurat e pranimit të studentëve

Procedura e pranimit të studenteve në programin MP në Financë me profile bazohet krahas bazës ligjore dhe akteve nenligjore edhe në rregullat e brendshme të UET-së (me hollësi të shih me sipër)

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Gjatë vizitës në insitucion u kërkuan të dhëna mbi notën mesatare hyrëse dhe dalje të studentëve. Ky dokument na u vu në dispozicion nga specialistja e ASCAL. Cilësia e hyrjes dhe daljes të studentëve në MP në Financë e shohim kryesisht në notën mesatare të programit bachelor e cila varion në vite nga 5.2 deri në 10. Ky variacion ka të bëjë me faktin se nuk ka patur kritere strikte në vendosjen e një note mesatare dyshme poshtë të cilës të mos kishte të drejtë regjistrimi kandidati për MP. Nga shqyrtimi i notës mesatare të hyrjes të studenteve të këtij programi vëmë re që për tre vitet akademike të fundit ajo ka patur prirje rënëse përkatësisht nga 6.61; në 6.29 gjë që tregon për një nivel relativisht të ulët të cilësisë së studentëve në hyrje..

2015-2016 nota mesatare në hyrje 6.61
2016-2017 nota mesatare në hyrje 6.41
2017-2018 nota mesatare në hyrje 6.29

Cilësia në dalje e studenteve që kanë përfunduar studimet në këtë program shihet në notën mesatare të daljes. Vëmë re që nota mesatare në dalje për tre vitet e fundit ka qenë pak më e lartë se në hyrje përkatësisht; nga 7.17; në 7.11. Porë në tërësi konkludojmë se në këtë program cilësia e një pjesë të numrit të studenteve të regjistruar duhet konsideruar relativisht e ulët.

2014-2015 nota mesatare në dalje 7.17
2015-2016 nota mesatare në dalje 6.85
2016-2017 nota mesatare në dalje 7.11

Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë).

Mbështetur në të dhënat e marra nga institucioni lidhur me studentët e regjistruar në këtë program që nga akreditimi i parë i tij vërejmë që:

- Numri i studenteve të regjistruar ka ardhur në rritje nga 52 studentë të regjistruar në vitin akademik 2012-2013, në 140 studentë të regjistruar në vitin akademik aktual 2017-2018
- Pothuajse 80% deri 85 % të numrit të regjistruar të studenteve i përkasin dy profileve; “Banka” dhe “Kontabilitet dhe raportim financiar”

- Profilet e tjera kanë një numër shumë të kufizuar studentësh,
- Profili “**Sigurime**” që nga viti 2013 deri në vitin 2016 nuk ka patur fare studentë, për këtë vit akademik rezultojnë vetëm 4 studentë
- Programi MP në Financë me sitemin 60 kredite ka dhe numrin më të madh të studentëve të regjistruar.

Të dhënat jepen në (Tabelën 14 në Aneks)

Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare

Numri i studenteve të diplomuar për vitin akademik 2016-2017(pa vite përsëritese) është 76 studentë ndaj 110 studentë të regjistruar apo 69% e tyre.

Të dhënat jepen në (Tabelën 15 në Aneks)

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend, Të dhëna për punësimin e studentëve, Të dhëna për punësimin e studentëve

Nuk ka të dhëna të plota për shkak të pamundësisë për të kontaktuar me të diplomuarit. Për studentët e diplomuar në këtë program është karakteristik që një pjesë e konsiderueshme e numrit të tyre kanë qenë të punësuar që në momentin e regjistrimit ose gjatë zhvillimit të programit.

Numri total të diplomuarve

Numri i studentëve të diplomuar në programin Mp në Financë në 6 vitet e fundit ka ardhur në rritje rrjedhojë kjo e regjistrimeve në këtë program që gjithashtu kanë qenë në rritje gjatë këtyre viteve. Gjatë këtyre viteve nga 486 studentë të regjistruar (pa përfshirë vitin aktual akademik) janë diplomuar në **total 350 studentë** ose 72 % e të regjistruarve, nga ku 246 studentë janë diplomuar me 60 kredite, dhe 104 studentë me 90 kredite.

Të dhënat jepen në (Tabelën 16 në Aneks)

Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)

Nga evidentimi i institucionit, numri total i të punësuarve në përputhje me diplomën varion nga 16 % në vitin akademik 2012-2013, në 30 % në vitin e diplomimit 2015-2016. Theksojmë të dhënat janë jo të plota.

Të dhënat jepen në (Tabelën 15 në Aneks)

Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)

Numri total i të punësuarve jo në përputhje me diplomën është i ulët që gjatë viteve varion nga 2 deri në 7 studentë.

Të dhënat jepen në (Tabelën 15 në Aneks)

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Institucionit ju kërkuan dokumente shtesë lidhur me numrin e studentëve të regjistruar, diplomuar dhe notës mesatare, të cilat na u vunë në dispozicion dhe janë paraqitur në këtë raport.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p>Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p> <p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriteve të pranimit.</p>	<p>Nga verifikimi me zgjedhje që ne bëmë pranë sekretarisë mësimore konstatuam se në këtë program janë regjistruar studentët, të cilët zotërojnë diplomë bachelor me 180 kredite, dhe në disa raste diplomë të sistemit të vjetër 4 vjeçar.</p> <p>Të gjithë studentët e regjistruar në këtë program rezultuan që plotësonin kriteret e përcaktuara nga UET, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p>Në përputhje me ligjin e ri për arsimin e lartë studentëve të programeve “Master Profesional” nuk u kërkohet më mbrojtja e gjuhës së huaj, as si kriter në hyrje, as në dalje.</p> <p>Në përputhje me strategjinë e zhvillimit , politikat e pranimit të studentëve janë përmirësuar. Nga takimi me drejtues të institucionit u argumentua që arsyeja kryesore që ky program ofrohet me 60 kredite dhe afat 1 vit akademik është se ende ka interes më të madh nga aplikuesit për këtëprogram me këto karakteristika. Duke u bazuar në numrin e studentëve të regjistruar që nga akreditimi i parë vihet re se në këtëprogram numrim me të madh e zënë studentët që janë regjistruar në programin me 60 kredite.</p> <p>Mendojmë se institucioni duhet të synojë përthithjen e studentëve në këtë progra me një cilësi më të lartë. Një ndër kriteret efikase do të ishte caktimi i një note mesatare në hyrje në këtë program në nivelin minimal 6.</p>
Standardi IV.2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.	

Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;

Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;

Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.

Studentëve të programit u ofrohet informacioni i nevojshëm nga institucioni lidhur për mundësitë e punësimit në përfundim të programit nëpërmjet Zyrës së Karrierës, Bordeve të Tregut të Punës, Panairëve të Punës, etj.

Studenteve të programit që në momentin e aplikimit dhe regjistrimit informohen për statusin e akreditimit të programit dhe mundësitë të njohjes së diplomës brenda dhe jashtë vendit. Ky informacion plotsohet gjatë zhvillimit të programit me prezantimin e kuadrit rregullator të UET-së.

Institucioni fokusohet te procesi i këshillimit të karrierës për studentët, duke realizuar aktivitete për këtë gjë ose çdo student i interesuar mund të shkojë tek Zyra e Këshillimit të Karrierës për tu informuar për aspekte që ka interes.

Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.

Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;

Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;

Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.

GVJ konstatoi që ekzistonin statistika të plota pranë Zyrës së Protokollit, Arkivit dhe Statistikave lidhur me tregues të programit. Këto statistika merreshin nga zyra e Sekretarisë Mësimore dhe Zyra e Burimeve Njerëzore. Institucioni i analizon këto të dhëna për të nxjerrë konkluzione të vlefshme për procesin e vendimmarrjes.

Nga verifikimi i bërë konstatohet se UET mban rekorde të detajuara në lidhje me studentët e regjistruar, studentët me bursë, studentët e transferuar, ata që kanë ndërprerë studimet për një periudhë afatshkurtër, ata që janë çregjistruar, si edhe studentët e diplomuar për program studimi. Në u kërkua të dhëna shtesë lidhur me statistikën që ka institucioni për studentet e këtij programi të cilat na u vunë në dispozicion dhe një pjesë e tyre paraqiten tek anekset në fund të këtij raporti.

GVJ verifikoi me zgjedhje dosjet e studentëve që plotësohej në vazhdimësi nga sekretaria. Në to kishte të dhëna rreth ecurisë

	sërezultateve të studentëve tëprogramit.
--	--

Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.

Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;

Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.

Nga takimet dhe të dhënat e marra në Zyrën e Karrierës te institucionit pamë që bëheshin përpjekje për të siguruar të dhëna nëpërmjet kontakteve me studentët e diplomuar. Baza e të dhënave e ngritur në këtëdrejtim megjithëse ka pasur përmirësim në aspektin sasior, ende nuk është e plotë, për shkak subjektive të studentëve të diplomuar që shpesh nuk japin të dhëna ose nuk përgjigjen në adresat që kanë depozituar në institucion gjatë zhvillimit të programit. Ngritja e shoqatës së Alumni, krijon premisë më të mira lidhur me sigurimin e këtyre të dhënave. Studentë te Alumni janë të përfshirë në Bordet e Tregut të Punës pranë Departamenteve.

UET organizon çdo vit takim me UET Alumni. Të diplomuarit zgjedhin një kryetar dhe nëpërmjet tij UET mban lidhje me ta, për të parë ecurinë e tyre dhe arrijtjet në sferën profesionale, megjithate ky informacion për studentët e MP në Financë nuk është plotë, pasi sic e kemi thesuar një pjesë e tyre janë të punësuar gjatë zhvillimit të programit dhe pas diplomimit ndryshojnë adresat dhe humbasin kontaktet me institucionin.

Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.

Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;

Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;

Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.

Studentët e programit informohen që në momentin e regjistrimit dhe në vijimësi rreth treguesve sasior dhe cilësor të programit. Gjithashtu, informacioni ndodhet në faqen e internetit të universitetit, u dërgohet elektronikisht përmes adresave elektronike, si edhe shpallen në tabelat e njoftimeve.

Nga takimi me studentët morëm informacion se pas secilës detyrë apo provim, pedagogët

	<p>zhvillojnë seanca sqaruese me studentët, për të sqaruar paqartësitë e mundshme në lidhje me vlerësimin e kryer. Pas kësaj seance pedagogu dorëzon procesverbalin me rezultatet e studentëve. Prej vitit 2016, në UET ka filluar të përdoret platforma LMS – Learning Management System e cila, jo vetëm lehtëson procesin mësimor, po edhe rrit mundësitë për informim dhe komunikim më të shpeshtë me studentët sipas nevojave të tyre.</p> <p>Rezultat e vlerësimeve diskutohen hapur brenda orës sqaruese për çdo provim nga titullarët dhe asistentët e lëndës</p>
--	---

Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.

Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;

Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.

Zyra e Kujdesit ndaj Studentit ndjek ecurinë e studimeve të studentit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij duke ofruar konsulencë për çështje akademike dhe studentore. Ky shërbim nuk zëvendëson këshillimin që jepet nga personeli akademik gjatë orëve të tutoriatit dhe këshillimit akademik.

Nga takimi që patëm me studentët ata na informuan që Zyra e Karrierës u ofron shërbim studentëve të programit duke ofruar informacion në lidhje me mundësi punësimi, apo aktivitete studentore që zhvillohen brenda ose jashtë vendit, duke ofruar njëkohësisht asistencë për kryerjen e aplikimeve apo këshillimin e nevojshëm.

Kjo zyrë ka krijuar kontakte të shumta me kompani private dhe institucione shtetërore dhe bashkëpunon ngushtë jo vetëm në funksion të zhvillimit të praktikave profesionale të studentëve pranë këtyre institucioneve, por edhe në kuadër të punësimit të ardhshëm të studentëve në këto kompani e organizata.

Konkluzionet e vlerësimit:

Studentëve të programit u ofrohet informacioni i mjaftueshëm që në fazën e aplikimit, dhe gjatë zhvillimit të programit lidhur me procedurat, aspekte sasiore dhe cilësore të programit, mundësi të punësimit etj. Faza e këshillimit të tyre realizohet nga pedagogët që zhvillojnë mësim në kete program por sidomos nga Zyra Kujdesit ndaj Studentit dhe Zyra e Karrierës. Të frytshme do të vlerësonim takimet në fokus grup me studentët.

Bazuar në RVB , takimet e realizuara gjatë vizitës në institucion me studentët, zyrës së Sekretarisë

Mësimore, zyrës së kujdesit ndaj Studentit dhe Zyra e Karrierës , si dhe verifikimeve në vend me zgjedhje të dokumenteve të tjera të kërkuara dhe marrë nga institucioni, konkludojmë se programi i studimit MP ne Finance me 5 profile i **plotëson plotësisht standardin e rubrikës studentët.**

Rekomandime:

- *Institucioni duhet të ketë një database më të plote të dhënash lidhur me punësimet e studentëve të diplomuar të këtij programi.*

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

UET-ja që në vitet e para të veprimtarisë së saj është fokusuar edhe në komponentin e kërkimit shkencor si një nga komponentet e zhvillimit tregues i nivelit të institucionit.

Gjatë vizitës në institucion ne u njohëm me Strategjinë e Kërkimit Shkencor të Institucionit i cili përfshin periudhen afatmesme 2017-2020. Vumë re nëpërmjet informacionit që morëm se kjo strategji ishte rrjedhojë e një diskutimi të gjerë të stafit dhe njësisve bazë të institucionit. UET është i angazhuar të ndërmarrë kërkim shkencor duke evidentuar vlerat akademike dhe novacioneve në fushat e ekonomisë, inxhinirisë dhe atë sociale. Zhvillimet në këtë drejtim i shohim në realizimin e disa produkteve dhe aktiviteteve shkencore në rang universiteti si:

- Ngritjen dhe botimin e konsoliduar tashmë te dy revistave shkencore ndërkombëtare: Economicus (ISSN: 2223-6295) dhe Polis (ISSN: 2223-8174). Economicus publikon kërkime në fushën e ekonomisë, zhvillimit dhe IT, ndërsa Polis publikon kërkime në fushën e shkencave humane dhe shoqërore. Revistat publikojnë artikuj vetëm në gjuhën angleze, mbështeten në një proces ‘double blind peer review’ dhe kane faqet e internetit të dedikuara
- UET-i siguron një program trajnimi të strukturuar për stafin akademik në përputhje me gradën shkencore dhe angazhimin në hulumtim. Institucioni ofron trajnime për botimin dhe kryerjen e kërkimeve në grup për stafin akademik.
- Institucioni ofron procedura bashkëkohore të vlerësimit të punës shkencore të stafit akademik. Ne verifikuam jo vetëm indikatorët e performancës kërkimore për pedagogët por edhe vlerësimin e kësaj performance për disa antarë të stafit akademik. Vlerësimi me pikë i kësaj performance ishte i ndarë sipas gradave dhe titujve shkencore.
- Në funksion të performancës së kërkimit shkencor, institucioni mbështet financiarisht këtë veprimtari për stafin akademik, praktikë kjo bashkëkohore. Lidhja e shpërblimit financiar me arritje të matshme akademike është një mekanizëm i përshtatshëm për të kontrolluar dhe inkurajuar veprimtarinë shkencore dhe botimet.
- UET ofron mobilitete për studentët, stafin dhe kërkuesit si një nga mjetet më të sukseshme për avancimin e kërkimit shkencor dhe rritjen e standardit të produktit të kërkimit shkencor.

Duke pasur parasysh lidhjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien, në programin MP në Financë me profile, studentët janë nxitur vazhdimisht të ndërmarrin kërkime shkencore kryesisht gjatë fazës së përgatitjes së diplomës.

Këtu roli i udhëheqësve të diplomave është parësor për faktin se ky program ka më shumë karakteristikë rritjen profesionale se sa atë shkencore dhe teorike. Një pjesë e mirë e stafit akademik ka marrë pjesë në konferenca dhe veprimtari të ndryshme shkencore brenda dhe jashtë vendit.

Të dhëna për aktivitete shkencore dhe përfshirjen e studentëve në to jepen në **Tabelën 17 në Aneks.**

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për kërkimin shkencor

Kërkimi shkencor në UET realizohet nëpërmjet a) botimit të 2 revistave shkencore në gjuhë të huaj; b) ndërtimit të një sistemi vlerësimi me pikë të performancës të stafit akademik, dhe në funksion të kësaj mbështetje me grande financimi të stafit në këtë fushë; mobiliteteve të stafit akademik në kuadër të projekteve, bashkëpunimeve shkencore që ka institucioni me ato homologe brenda dhe jashtë vendit.

Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL

Mbështetur në të dhënat e institucionit numri i botimeve nga PAE i institucionit gjatë 3 viteve të fundit është 456 botime brenda dhe jashtë vendit. Pjesë e konsiderueshme e këtyre botimeve janë pranë dy revistave shkencore që boton vetë institucioni. Nxitja e publikimeve shkencore nga PAE është rrjedhojë edhe e metodologjisë së vlerësimit të performancës shkencore nga institucioni.

Numri i projekteve kërkimore të fituara

Mbështetur në të dhënat e institucionit, numri i projekteve kërkimore të fituara është 11, ku shumica janë në kuadër të projektit ERASMUS +.

Numri i projekteve të zbatuara, Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL, Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda IAL, studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor

Mbështetur në të dhënat e institucionit, numri i projekteve kërkimore të zbatuara deri tani është 20, numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga institucioni është 13, dhe numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda institucionit është 270 Mbështetur në të dhënat e institucionit, numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor është 17. Bazuar në numrin total të studentëve në vite mendojmë se ky numer është shumë minimal. Gjithashtu, asnjë nga studentët e programit MP në Financë me 5 profilet nuk ka qenë i përfshirë në kërkimin shkencor. Kjo është edhe rrjedhojë e natyrës së programit me karakter më shumë aplikativ, por edhe i nivelit cilësor të ulët në hyrje të studentëve të këtij programi

Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor

Ska

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
--------------------	-----------------------------

51

Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.

<p>Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p>	<p>Vlerësimi me bonus financiar nëpërmjet marrjes së gradeve nga institucioni për performancë shkencore të stafit ka stimuluar që PAE të publikojë rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse në revistat e institucionit, jashtë tij dhe në botimet në revista të huaja. Priorja tani është rritja e cilësisë së botimeve e lidhur kjo dhe me kuadrin ligjor dhe rregullativ aktual që kërkon publikime në revista me faktorë impakti mundësisht Thomson Reuters. Në vlerësimin e indikatorëve të performancës shkencore për stafin shohim se artikujt në këto revista cilësore kanë edhe vlerësimin me pikë më të lartë.</p> <p>Botimet shkencore të stafit akademik i referohen kryesisht trajtimeve teoriko shkencore të ekonomisë shqiptare (kjo për publikimet e stafit të programit MP në Financë si kontribute në këtë fushë të ekonomisë shqiptare.</p>
--	---

Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.

<p>Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	<p>Një pjesë e PAE me tituj akademik të departamentit të financës dhe ekonomisë, që mbulon edhe programin MP në Financë me profile, janë angazhuar në mësimdhënie në gjuhë të huaj në disa Universitete Europiane në gjuhën angleze. Nga këta profesorë mund të përmendim:</p> <p>Prof. Dr. Luljeta Minxhozi Prof. Asoc. Dr. Selami Xhepa.</p> <p>Pedagogët që janë angazhuar në mësimdhënie në gjuhë të huaj, kanë përvojë mësimdhënieje në univesitetet e huaja, prej së paku një semestri.</p>
---	---

Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.

<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>Departamenti i Financës dhe Ekonomisë si njësi e mbulimit të programit MP në Financë, realizon leksione të hapura me pjesëmarrje pedagogë të huaj apo specialist të mirnjohur të fushës së financës dhe bankës, me synim marrjen e përvojës metodologjike dhe pedagogjike nga stafi i Departamentit.</p> <p>Nga informacioni i marrë dhe i verifikuar gjatë</p>
--	--

	<p>takimit në institucion me stafin akademik të këtij programi, PAE i Departamentit të Financës dhe Ekonomiksit janë angazhuar në programe kërkimore nëpërmjet pjesëmarrjes në projektet e UET-së dhe jashtë tij ku institucioni është partner në to. Disa nga këta antarë të stafit kanë qenë në vizita pranë universiteteve të huaja për periudha që variojnë nga 1 deri 6 muaj.</p> <p>Nga biseda në institucion u theksua se afro 60 % e PAE janë të përfshirë në projekte të tilla.</p>
--	--

Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.

<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p>Departamenti i Financës dhe Ekonomiksit ka në dispozicion axhendën kërkimore të secilit pedagog në harkun e 5 viteve, si dhe një bazë të plotë të dhënash të punës kërkimore, botimeve dhe pjesëmarrjeve me kumtesë në konferenca brenda dhe jashtë vendit të stafit në çdo fund viti akademik..</p> <p>Zyra e Zhvillimit të Projekteve dhe Kërkimit në UET disponon një bazë të dhënash (Excel spreadsheet) me detaje të projekteve kërkimore, zhvillimi, ndërtim-kapacitetesh etj. në të cilat ka marrë pjesë ose është aktualisht ipërfshirë personeli akademik, si dhe me detaje të projekteve në aplikim/të ardhshme. Baza e të dhënave përmban detaje për projektin, për donatorin, për partnerët, për personelin akademik të përfshirë.</p>
---	---

Konkluzionet e vlerësimit:

UET-ja ka pasur zhvillime shumë pozitive lidhur me kërkimin shkencor gjatë 3 viteve të fundit. Kjo është e materializuar nëpërmjet përfshirjes në shumë projekte kërkimore të institucionit me universitete apo institucione brenda dhe jashtë vendit. Projektet e partnerit në kuadër të programeve EERASMUS + zënë numrin më të madh të projekteve ku institucioni është palë.

Metodologjia e vlerësimit të performancës shkencore të PAE ka qenë nxitëse për të rritur botimet shkencore në revistat shkencore të botuara nga vetë institucioni por edhe jashtë vendit. Ky vlerësim lidhet njëkohësisht edhe me përfitimet e graveve financiare nga ana e PAE në rastin e një performancë të mirë të veprimtarisë shkencore. Zyra e projekteve të institucionit është aktive në procesin e bashkëpunimit shkencor në projekte të ndryshme, informimin e PAE lidhur me mundësitë e aplikimit deri edhe në ndërmarrjen e iniciativës për të aplikuar në kuadër të projekteve edhe si lider. Gjithë veprimtaria shkencore e institucionit evidentohet me saktësi nëpërmjet krijimit të një sistemi të dhënash.

Bazuar në RVB, takimet e realizuara gjatë vizitës në institucion me drejtues të tij, zyrën e projekteve, si dhe verifikimeve në vend të botimeve në revistat shkencore të botuara nga institucioni por edhe me gjerë, konkludojmë se programi i studimit MP në Finance me 5 profile, **e ploteson plotësisht**

standardin e rubrikës së kërkimit shkencor..

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

UET gjatë 3 viteve të fundit akademike (2014-2017) ka rritur nivelin e bashkëpunimit në nivel lokal dhe ndërkombëtar, gjë që kontribon në marrjen e praktikave më bashkëkohore akademike në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies lidhur me personelin akademik dhe studentët. Bazuar në të dhënat e marra gjatë vizitës në institucion dhe RVB, institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi në nivel lokal partneritet, shkëmbime akademie apo Erasmus +, me 15 institucione të arsimit të lartë në Shqipëri dhe me 16 institucione të tjera të shoqërisë publike. Zhvillim pozitiv në këtë fushë shohim në marrëveshjet e bashkëpunimit ndërkombëtar të institucionit. Kështu gjatë kësaj periudhe ka pasur apo janë në proces bashkëpunimi me rreth 93 universitete apo institucione Europiane në kuadër të projekteve të ndryshme ERASMUS +, partnership etj. Nga ky numër 6 marrëveshje bashkëpunimi janë me Universitetet në Kosovë. Ky numer i madh marrëveshjesh bashkëpunimi që ka përfshirë të tre nivelet e programeve mësimore që zhvillohen ka mundësuar edhe realizimin e mobiliteteve në kuadër të shkëmbimeve të stafit, personelit administrativ dhe studentëve të UET-së, me këto institucione partnere. Gjatë kësaj periudhe janë dërguar tek këto universitete partnere 51 antarë të stafit ku 30 prej tyre kanë qenë mobilitete për qëllime kërkimore / mësimore. Për të njëjtën periudhë UET ka pritur 18 punonjës nga universitetet e BE-së, 15 prej të cilëve kanë kryer aktivitete hulumtuese / mësimore. Në këtë kuadër UET ka pritur 13 studentë të huaj, nga të cilët 6 kërkues doktorantë dhe 1 student MA që ka kryer kërkime për tezën e tij. Sa u përket studentëve që shkojnë nga UET në universitete të BE, UET ka qenë institucioni dërgues i 38 studentëve, nga të cilët 6 studentë të doktoraturës. Aktualisht, UET ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me CEU-Budapest dhe është bërë pjesë e Programit CEU të Ndhmës Globale. Duke filluar nga shtatori 2017, UET do të presë lektorët dhe kandidatët e avancuar të doktoratës të CEU, të cilët do të japin mësim dhe ndërmarrin kërkim shkencor në UET. Gjithashtu, për vitin akademik 2017-2018 UET ka aplikuar për 31 marrëveshje Erasmus + për të mundësuar mobilitete për 207 studentë dhe kërkues.

Një ndërmarrje e rëndësishme e UET duhet konsideruar edhe ndërtimi i rrjetit 'Next Europe', nën kujdesin e Zyrës së Projekteve për Kërkim dhe Zhvillim. Ky rrjet synon të trajtoj me përparësi problematikën e demokratizimit, zhvillimit ekonomik-shoqëror dhe institucional të vendeve të Ballkanit Perëndimor duke u fokusuar tek parametrat e modernizimit dhe europianizimit të tyre si në planin politik ashtu edhe ekonomik e social. UET ka tashmë marrëveshje institucionale për kërkimin shkencor me La Sapienza University of Rome, Itali, me fokus seminare doktorale si dhe Central European University, Budapest, me fokus programin "Global Teaching Felloëship për shkëmbim stafi akademik.

Institucioni mbështet edhe aplikimet individuale të stafit akademik në kuadër të projekteve të zhvillimit të kapaciteteve të arsimit të lartë si Erasmus+ KA1 dhe KA2 të Komisionit Europian; të projekteve kërkimore dhe rrjetëzimit si COST dhe Horizon2020 të Komisionit Europian etj.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar shih treguesit e mëposhtëm(sipas RVB)

1	Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare	13
2	Numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj (ose orë mësimore)	37
3	Numri i pjesëmarrësve në trainime fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit	30 (erasmus + staf akademik)
4	Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt programit të studimit	13 student kanë ardhë në UET përmes bursave Erasmus + 38 student nga UET kanë përfituar bursa Erasmus + 19 student të UET kanë lëvizur përmes programeve të tjera të BE (SIGMA) dhe programeve bilaterale
5	Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor	Biblioteka, Abonimi në EBSCO, SAGE online si edhe të tjera burime online; Laborator IT; infrastrukturë anti-plagjarizëm; Salla konferencash dixhiitale; trajnimi i brendshëm i stafit akademik; Kërkimi me Impakt; Si të komunikojmë Shkencën; UET Research group; Si të aplikojmë për projekte; etj. Ditët Doktorale; Revistat Shkencore (Economicus dhe Polis); Ditë Informativ për grante kërkimore në nivel Europian (AKTI, RCE, etj.); Ditët e Studimeve Shqiptare;
6	Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime	21 (erasmus + staf administrativ)
7	Numri i Çmimeve ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.	1

Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë jepen në treguesit e mëposhtëm(sipas RVB).

Institucionet të shoqërisë civile dhe ndërkombëtare si partnerë/donatorë		
Këshilli Britanik	Tiranë	Provimet IELTS
Ambasada e Britanisë në Tiranë	Tiranë	Programe shkëmbimi
Komisioni European	Bruksel	Jean Monnet Chair/Tempus
Mediterranean Citizens' Assembly	Francë	Zhvillimi i Mesdheut
Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ)	Tiranë	Mekanizmi gjurmues për të diplomuarit në tregun e punës
Groëth for Knoëledge - GFK + GFK Verein	Austri	Kërkim tregu - Trajnim
NUFFIC – Ambasada Hollandeze	Tiranë	Trajnim për zhvillimin e kapaciteteve të Qendrës UET dhe ITAP
UNICEF	Tiranë	Gjithëpërfshirja shoqërore dhe të drejtat e njeriut

UNDP	Tiranë	Lufta kundër korrupsionit dhe roli I universitetit
Ambasada e SHBA-ve	Tiranë	Forcimi I sigurisë njerëzore nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes së komunitetit
Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë - Soros	Tiranë	Shqipëria drejt Bashkimit Europian përmes Zhvillimit Rajonal
		Vlerësim i nivelit/potencialit të shkollave për të përballuar me sukses procesin e vetëvlerësimit
		Refleksione mbi sistemin e edukimit parauniversitar në Shqipëri
Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile	Tiranë	FCO-Platforma Online
		Aty ku puna takon punonjës
		Studim mbi Çamërinë
Komisioneri për Mbrojtjen kundër Diskriminimit	Tiranë	Gjithëpërfshirja shoqërore dhe të drejtat e njeriut
Fondacioni ABC	Tiranë	Ide të reja për sipërmarrje të reja
Agjencia Zviceriane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC)	Tiranë	RRPP – Projekt kërkimor rajonal për fenomenin e 'fëmijëve të rrugës'
Ëorld Vision	Tiranë	Gjithëpërfshirja shoqërore dhe të drejtat e njeriut

Bazuar në të dhënat e marra gjatë vizitës në institucion dhe RVB institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi në nivel lokal (partneritet, shkembime akademie apo Erasmus + me 15 institucione të arsimit të lartë nëShqipëri dhe me16 institucione të tjera të shoqërisë publike.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	
<p>Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p>Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimim e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>Studentët e programit MP në Financë në 5 profile që janë të punësuar, e zhvillojnë praktikën profesionale pranë ndërmarrjeve apo institucioneve ku punojnë Pjesa tjetër e studentëve që nuk janë të angazhuar në marrëdhënie punësimi kanë mundësi që nëpërmjet programit 250+ të realizojnë praktikën profesionale pranë një nga këto kompani me të cilat UET ka marrëveshje bashkëpunimi. Një ndër praktikat e njohura është realizimi i intershipeve të studentëve pranë këtyre kompanive që u jep mundësi të rritjes profesionale.</p> <p>Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi reciproke me këto 250 kompani duke siguruar krahas angazhimit të studentëve nërealizimin e kryerjes së praktikave edhe kontaktet me drejtues të këtyre kompanive nëpërmjet takimeve të tyre që janë realizuar në ambjentet e UET-së me</p>

	studentet.
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit brenda institucionit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Nga takimi me antarë të stafit të Departamentit të Financës dhe Ekonomiksit, ne pamë praktikën e diskutimeve të stafit në fazën e hartimit të kurrikulës dhe programit. Mendimet e shfaqura në Departament janë objekt diskutimi dhe vendimi kolegjal.</p> <p>Departamenti i Financës dhe Ekonomiksit si njësi që e mbulon këtë program studimi ka rregulloren e tij të veprimtarisë dhe rregulloren e programit MP në Financë. Këto akte rregullative u japin përgjegjësinë stafit dhe njëkohësisht u shëbejnë bashkëpunimit mes antarëve të stafit.</p>
Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.	
<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Institucioni ka rritur ndjeshëm gjatë viteve të fundit marrëdhëniet e bashkëpunimit me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, kompani që operojnë në tregun shqiptar me mundësi përfitimi për studentët e këtij programi.</p> <p>Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me kompani të biznesit brenda vendit për tu mundësuar studentëve të MP në Financë që nuk janë aktualisht të punësuar për të realizuar praktikën profesionale pranë tyre.</p> <p>Gjithashtu janë realizuar takime trajnuese dhe informuese për studentët e programit me menaxherë të kompanive sipërmarrëse lidhur me dhënien prej tyre të eksperiencës në biznes.</p> <p>Impakti i kontakteve të institucionit me drejtues të kompanive të biznesit me të cilët ka marrëveshje bashkëpunimi shihen në të dhënat që disponon institucioni lidhur me numrin e studentëve që kanë realizuar praktikat profesionale pranë tyre.</p>




Konkluzionet e vlerësimit:

GVJ vlerëson se UET gjatë 3-4 viteve të fundit ka rritur ndjeshëm nivelin e bashkëpunimit institucional në kuadrin lokal dhe ndërkombëtar duke krijuar në bazë të qëndrueshme përfitimesh të stafit të saj akademik, administrativ dhe të studentëve për të pasur përfitime në procesin e mësimdhënies dhe mëimnxënies, dhe praktikave bashkëkohore për to. Institucioni ka artitur që nëpërmjet marrëveshjeve me institucione dhe kompani të biznesit vendase (projekti 250 +) të rrisë sigurinë e realizimit të praktikave profesionale të studentëve të programit MP në Financë pranë tyre. Kjo përbën edhe premisë që pas kryerjes së praktikës profesionale kompanitë të mund të punësojnë një numër tëstudentëve të ketij programi. Nga ana tjetër Bordet e Tregut të Punës të ngritura pranë cdo departamenti si dhe Panairi i punes që zhvillohet nga UET çdo vit rrisin mundësitë e punësimit për studentët e diplomuar të këtij program.

Bazuar në RVB , takimet e realizuara gjatë vizitës në institucion, si dhe verifikimeve në vend të dokumenteve të tjera të kërkuara dhe marrë nga institucioni konkludojmë ;se programi i studimit MP në Finance me 5profile, **e plotëson plotësisht standardin lidhur me bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun**

Ekspertët e Vlerësimit të Jashtëm

Prof.Dr.Halit XHAFA

Prof.Dr.Drini SALKO



ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

GVJ vlereson se Institucioni ka treguar vemendjen e duhur lidhur me plotësimin e mangësive të vërejtura nga vlerësimi i bërë në vitin 2010 lidhur me akreditimin e programit (atëherë i konsideruar si MNP në “Banka dhe Sigurime “ me tre profile) duke përmirësuar ndjeshëm këto mangësi. Kështu institucioni:

- a) **Ka plotësuar kryesisht rekomandimin mbi përmirësimet në program** duke përmirësuar ndjeshëm mangësitë lidhur me përmbajtjen e syllabusve që tashmë përmbajnë të gjithë elementet e duhur në formë dhe përmbajtje. Kërkohej axhustimi i syllabusve për lëndet që janë të njëjta me programin MSc në finance duke shmangur me shumë përsëritjet në disa lende.
- b) **Ka plotësuar plotësisht rekomandimin lidhur me mbulimin e programit me PAE.** Kjo mangësi është eliminuar gradualisht gjatë viteve pas akreditimit të parë duke rritur numrin e pedagogëve të brendshëm me tituj e grada dhe pothuajse mbi 77 % e mësimin në vitin akademik aktual zhvillohet nga personel efektiv..
- c) **Ka plotësuar plotësisht rekomandimin e rritjes së bashkëpunimit në nivel lokal dhe nderkombetar,** gjë që kontribuon në marrjen e praktikave më bashkëkohore akademike në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies lidhur me personelin akademik dhe studentët. Një numër i madh marrëveshjesh bashkëpunimi ka përfshirë të tre nivelet e programeve mësimore që zhvillohen ka mundur edhe realizimin e mobiliteteve në kuadër të shkëmbimeve të stafit, personelit administrativ dhe studentëve të UET-së, me këto institucione partnere.
- d) **Ka plotësuar plotësisht rekomandimin lidhur me procedurat e veçanta të pranimit në institucion për studentët.** Institucioni tashmë ka procedurë të plotë të regjistrimit bazuar në rregulloret e miratuara në institucion .
- e) **Ka plotësuar plotësisht rekomandimin lidhur me hartimin e strategjive të zhvillimit shkencor.**Tashmë UET e bazon veprimtarinë e vet edhe në strategjinë e zhvillimit shkencor afatmesëm që është miratuar.
- f) **Ka plotësuar kryesisht rekomandimin lidhur me mungesat e titujve në gjuhën shqipe.** UET është angazhuar vitet e fundit në një program përkthimesh të disa teksteve bashkëkohore të autorëve më të njohur në botë në fushën e financës bankës gjë që e ka përmirësuar këtë situatë. Meqënëse përdorimi i tyre vështirësohet herë pas here për shkak të diferencave në ambientin ekonomik, institucioni duhet të shtojë numrin e botimeve të autorëve vendas në disiplina bazë apo edhe në ato me zgjedhje.



II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT

a. Pika të forta:

- 1) Realizimi i programit kryesisht nga PAE (Personel Akademik Efektiv) i kualifikuar me eksperience dhe me tituj akademik dhe grada shkencore .
- 2) Realizimi i nje Sistemi te Brendshem te Sigurimit te Cilesis efektiv dhe te efektshem ne rritje te cilesise se mesimdhenies.
- 3) Procedura te plota dhe efektive lidhur me monitorimin dhe vleresimin e performances akademike dhe shkencore te stafit te programit nepermjet nje sistemi pikezimi nxites per progres.
- 4) Arrija e marreveshjeve te shumta bashkepunimi ne fushen e mesimdhenies dhe kerkimit shkencor me institucione homologe ne kuader te projekteve me institucionet homologe dhe bashkepunimi me sektorin e siper marrjes ne vend ne dobi te studenteve te diplomuar.

b. Pika të dobëta:

- 1) Niveli ende relativisht i ulët i cilesise ne hyrje te studenteve te ketij programi rrjedhoje e mos vendosjes edhe te nje kriteri tjeter hyres qe mund te ishte vendosja e nje note mesatare "dysHEME" te programit Bachelor poshte se cilës te mos regjistrohen aplikante ne kete program.
- 2) Numri i kufizuar i teksteve ne shqip kryesisht te autorëve vendas ne fushen e finances, banks, sigurimeve, kontabilitetit.
- 3) Dy apo tre nga profilet e ketij programi qe historikisht kane pasur nje numer te kufizuar studentesh te regjistruar (ne vite te caktuara ka pasu edhe 1 apo 2 studente te regjistruar ne to) perben nje kosto shtese per institucionin.
- 4) Programi ne lendet qe ofron apo trajton duhet te ketë me shume trajtime praktike nepermjet uljes se numrit per lendet e "trungu" te perbashket dhe shtimit t e lendeve te profilit perkates.

c. Mundësitë:

- 1) Axhustimi i programeve per pershtatje me te mire me tregun e punes me synim rritjen profesionale te studenteve
- 2) Rritja e rolit te stafit akademik dhe e kohes se angazhimit te tyre me studentet gjate fazes se pergatitjes se punimit te diplomes duke i "çliruar" nga nje numer i larte qe ata kane pasur ne kete program gjate këtyre viteve. Kjo do rriste cilesine e punimeve edhe ne funksion te punesimeve apo karieres se tyre.
- 3) Mungesa e nje programi MP ne Finance me 120 ECTS qe do ti paraprinte kekesave te pritshme te aplikante qe do te synonin kete program gjate viteve te ardheshme. Numri i vogel i lendeve te programit MP ne Finance me profile qe po zhvillohet dhe numri prej 2 lendesh me zgjedhje qe specifikojne profilin e ketij programi konsiderohen relativisht jo te plota per nje specialist te fushes se finances me profile.

d. Pengesat:

- 1) Konkurrenca nga universitetet e tjera publike dhe private
- 2) Ndryshimet ligjore dhe vonesat ne hartimin e gjithe kuadrit nenligjor dhe rregullativ.

SUMMARY OF ANALYSIS ON RVJ WITH THE SWOT METHOD (STRENGTHS, WEAKNESSES, OPORTUNITIES, THREATS).

a. STRENGTHS

- 1) The program is realized mainly from PAP (Permanent Academic Personel) well qualified and with experience that have received academic titles and scientific degrees.
- 2) An internal system for the assurance of efectiv Quality System is in place, aiming the increase of teaching quality.
- 3) Full and effective procedures are used to monitor and evaluate the academic performance of the staf and for the programme with a score system as incentive for progress.
- 4) There are a lot of collaboration agreements on the teaching methodology and scientific research woth other institutions on the framework of projects with these institutions, as well as the collaboration with the businesses that are interested for the best students.

b. WEAKNESSES

- 1) The relative low level of new entry students of this program as consequence of “no ceiling” level on Bachelor program that limits the entry of applicants below the level.
- 2) Limited number of textbook on Albania language mainly on domestic authors on finance, banks insurance an accounting.
- 3) Two or three from the program profile have had historically very limited registered students (some years only 1 or 2 students registered) with additional costs for the institution.
- 4) The program for the subjects offered should have more practical application with increasing the number of profile subjects and decreasing the number of core one.

c. OPORTUNITIES

- 1) The program reviewing will increase the quality of programs according to the demand of labour market , aiming the professional improvement of students.
- 2) Increase the number of academic staff role and extra time work during the preparation of the diploma. This will increase the quality of diploma as a good support for the employment and career.
- 3) The lack of a programme on Professional Master with 120 ECTS that can anticipate the possible requests from aplicants in the forthcoming years. Low number of subjects of PM in Finanance program which is in progress and with the two possibilities for preferred subjects, is relatively uncompleted for a financial direction specialist

d. THREATS

- 1) Competition from other private and public universities.
- 2) Legal changes and delays on drafting the by-laws and regulatory framework

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm

Prof.Dr.Halit XHAFA

Prof.Dr.Drini SALKO